

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6116
E enjte, 17 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Kosova dhe Maqedonia
e Veriut zotohen
se do t'i hapin kufijtë
pa kushte | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA REAGUAR
PËR PROCESIN E DIALOGUT TË BRUKSELIT | FAQE 4-5

THAÇI: KUVENDI T'IA NDALOJË KRYEMINISTRIT TË NEGOCIOJË PËR ÇËSHTJE TË BRENDSHME TË KOSOVËS



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar Qeverinë e Kosovës që të mos i hapë çështjet e brendshme me Serbinë në dialogun e Brukselit. Ai ka thënë se hapja e temave për të drejtat e

komuniteteve dhe për asociacionin është fillim i instalimit të republikës serbe në Kosovë. I pari i shtetit ka ftuar urgjentisht Kuvendin ta votojë një rezolutë përmes së cilës

kryeministrit i ndalohet të negociojë për çështje të brendshme. Në anën tjetër, kryeministri Avdullah Hoti ka mohuar se do të diskutohet për një gjë të tillë në Bruksel

SHKON NË MBI 14 MIJË NUMRI I TË INFEKTUARVE ME COVID NË KOSOVË



Tri viktima dhe 76 raste të reja me Covid-19 u konfirmuan në 24 orët e fundit në Kosovë. Në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës thuhet se rastet e reja rezultojnë nga testimi i 538 mostrave. Po ashtu, bëhet me dije se për 24 orë janë shëruar 165 pacientë. Numri total i rasteve pozitive me Covid-19 në Kosovë është 14 839 | FAQE 3



HOTI THOTË SE QEVERIA KA
FILLUAR PËRGATITJET PËR
ZBATIMIN E MARRËVESHJES
SË UASHINGTONIT | FAQE 3

OPINION

UNIVERSITETET DUHET
TË BËHEN AVANGARDË
E INTEGRIMIT | F. 11

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE

SBASHK-u: INSTITUCIONET MOS
TA LEXOJNË GABIMISHT
PËRKUSHTIMIN TONË | F. 6

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KUVENDIT DHE
MINISTRISË SË MBROJTJES | F. 6

EKONOMI

KËRKOHEM QË INDUSTRIA
E PRODHIMIT TË SHPALLET
SEKTOR I RËNDËSISË
NACIONALE | F. 9



KRASNIQI VIZITOI
'SHARRCEM'-IN, INTERESOHET
PËR PRODHIMIN E ÇIMENTOS
NË KËTË FABRIKË | F. 9

KULTURË

MINISTRJA DUMOSHI I JEP
PËRKRAHJE MAKSIMALE
PROJEKTIT RINOR NË GJILAN | F. 10

SPORT

PRISHTINA KONFIRMON
LARGIMIN E DALLKUT DHE
ARDHJEN E RAMADANIT | F. 16

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kosova dhe Maqedonia e Veriut zotohen se do t'i hapin kufijtë pa kushte

SHKUP, 16 SHTATOR - Maqedonia e Veriut dhe Kosova duhet sa më parë t'i heqin testet për koronavirus, të njohura si PCR, dhe ta mundësojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, thanë të mërkurën në Shkup zëvendëskryeministrat e dy vendeve, Artan Grubi dhe Besnik Tahiri. "Kufijtë tanë duhet të liberalizohen dhe këtu mund të merret si shembull kufiri mes Kosovës dhe Shqipërisë, që është i hapur dhe ka lëvizje të jashtëzakonshme mes dy vendeve, në veçanti gjatë sezonit turistik. Transmetimi i sëmundjes Covid-19 mes dy vendeve ka qenë minimal. Ky shembull duhet të na shërbejë edhe neve për t'i liberalizuar kufijtë jo vetëm me fqinjën tonë - Kosovën, por edhe me fqinjët tanë përreth", ka thënë zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, pas takimit me homologun Besnik Tahiri. "Për ne është e palogjikshme që të kemi një sistem të testimit

dypalësh. Përderisa lëvizja me Shqipërinë është e hapur, lëvizja mes dy vendeve ka qenë shumë e madhe. Duhet parë të gjitha mundësitë e lehtësimit edhe me Maqedoninë e Veriut, normalisht duke ruajtur shëndetin publik, duke ruajtur njëri-tjetrin dhe ta lehtësojmë lëvizjen e qytetarëve", ka thënë Tahiri.

Gjatë kësaj jave u paralajmërua mbajtja e një video-konference mes ministrave të Shëndetësisë të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor për miratimin e një protokollit për lehtësimin e lëvizjes mes vendeve të tyre.

Të hënën Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore u bënë thirrje qeverive të të dyja vendeve që t'i heqin pengesat në lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, respektivisht testet PCR. Sipas tyre, mbyllja e kufijve u ka shkaktuar dëme të mëdha bizneseve të dy vendeve. "Duke marrë parasysh lidhjen dhe



Zërfeta Hajro Jajega (RFE/RL)

afërsinë tokësore të Kosovës me Maqedoninë e Veriut, PCR testi negativ i obligueshëm, i vendosur për hyrje në të dyja shtetet, paraqet një pengesë shtesë si për personat fizikë, po ashtu edhe për bizneset sepse, së pari, goditet ekonomia, e cila pëson humbje të mëdha nga ky vendim", u tha në komunikatën

e dy odave ekonomike.

Në takimin e dy zëvendëskryeministrave në Shkup u bisedua edhe për autostradën Shkup - Prishtinë, respektivisht ngecjen e punimeve në pjesën e Maqedonisë së Veriut. "Segmenti Shkup - Bllacë për ne është shumë i rëndësishëm.

Ne e kemi kryer rrugën tonë në pjesën tonë. Mendoj se ky segment do t'i lidhë edhe më fuqishëm dy vendet tona, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, duke e forcuar bashkëpunimin ekonomik dhe lëvizjen e njerëzve", ka thënë zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Tahiri.

Osmani promovoi projektin në mbrojtje kundër Covid-19 për kategoritë e rrezikuara sociale



PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, mori pjesë në përfundimin e projektit "Furnizimi me mjete mbrojtëse kundër Covid-19 për kategoritë e rrezikuara sociale", në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve.

Projekti është mbështetur nga Kuvendi i Kosovës dhe Ambasada e Luksemburgut, ndërkaq është realizuar nëpërmjet Organizatës për

Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve (PRAK). Projekti synon ta furnizojë me maska dhe dezinfektues këtë kategori, e cila konsiderohet me rrezikshmëri më të lartë të infektimit.

Nga ky projekt mbështeten tetë strehimore në nivel vendi, shtëpitë për komunitet, shtëpitë për të moshuar, SOS fshatrat e fëmijëve, Instituti Special i Shtimes dhe shfrytëzuesit e banesave sociale. Kryetarja

Osmani falënderoi ekipin e strehimores për punën që po bën, teksa e vlerësoi të domosdoshëm zbatimin e masave anti Covid-19.

Drejtueset e strehimores theksuan nevojën për mbështetje më të madhe nga niveli qendror, posaçërisht nëpërmjet linjave të përhershme buxhetore, me të cilat mundësohet stabilitet në punën me viktimat e dhunës në familje si dhe kategorive të ngjashme.

Irlanda konfirmon përkrahjen për Kosovën

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka zhvilluar një bisedë telefonike me ministrin e Jashtëm dhe të Mbrojtjes të Republikës së Irlandës, Simon Coveney. "Shprehja mirënjohje për Irlandën si pjesë e grupit të parë të shteteve që kanë njohur Kosovën në ditët e para të shpalljes së pavarësisë. Z. Coveney e njoftova për marrëveshjen e Uashingtonit dhe kërkova që edhe Irlanda ta përkrahë njohjen reciproke në kufijtë ekzistues si epilog përfundimtar në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar

Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në "Facebook".

Ajo ka treguar se ministri Coveney i ka konfirmuar përkrahjen e fuqishme të Irlandës për zgjerimin e Bashkimit Evropian drejt Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se anëtarësimi në BE do të ketë efekt të fuqishëm transformues dhe ndikim të madh stabilizues në rajon. "U pajtuam që ta thellojmë bashkëpunimin bilateral për t'i forcuar lidhjet tona politike dhe ekonomike dhe ta orientojmë rininë e Kosovës drejt BE-së, në shtëpinë e tyre natyrale, gjeografike dhe politike", ka deklaruar ministrja Haradinaj-Stublla.



Shkon në mbi 14 mijë numri i të infektuarve me Covid në Kosovë

Tri viktima dhe 76 raste të reja me Covid-19 u konfirmuan në 24 orët e fundit në Kosovë. Në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës thuhet se rastet e reja rezultojnë nga testimi i 538 mostrave. Po ashtu, bëhet me dije se për 24 orë janë shëruar 165 pacientë. Numri total i rasteve pozitive me Covid-19 në Kosovë është 14 839



2 raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Drenas, Malishevë, Prizren, Rahovec dhe Shtime.

Zemaj: Respektimi i masave anti Covid në shkollën 'Ismail Qemali', në nivelin e duhur

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të

mërkurën shkollën "Ismail Qemali" në Prishtinë, për ta parë nga afër respektimin e masave antiCovid. Ai ka thënë se respektimi i këtyre masave në këtë shkollë ishte në nivelin e duhur. "Shqetësues është grumbullimi i prindërve në oborr të shkollës, me arsyetimin e përcjelljes së nxënësve. Lus prindërit që mos të shkaktojnë grumbullime në oborre të

shkollave dhe i inkurajoj ata për kujdes të shtuar. Do të jemi çdo ditë në terren, pa paralajmërim në shkolla dhe institucione të ndryshme, për të parë se si po zbatohen masat antiCovid. Respektimi i rregullave antiCovid do të sjell sukses edhe në mësimnxënie, edhe për shëndetin e nxënësve, për ne si prind dhe arsimtarët", ka thënë ministri Zemaj.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë, me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 538 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 76 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të vdekjes me Covid-19. Numri total i rasteve pozitive është 14 839, nga 59 571 persona të dyshimtë në virusin

SARS-CoV-2 dhe 604 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 165 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 11 949 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 286.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 12 raste, komuna Gjilan 11 raste, komuna Klinë 9 raste, komuna Fushë Kosovë 6 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Podujevë 5 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Gjakovë 3 raste, komuna Kamenicë 3 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Mitrovicë

Hoti thotë se qeveria ka filluar përgatitjet për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit

Në tryezën e organizuar nga KDI-ja në kuadër të "Platformës së shoqërisë civile për dialogun", kryeministri Avdullah Hoti ka prezantuar parimet dhe objektivat e qeverisë lidhur me procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka treguar se qeveria ka filluar përgatitjet për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit dhe në ditët e ardhshme do të përgatiten edhe planet për obligimet e ministrive përkatëse për zbatimin e kësaj marrëveshje



përhershëm" duke i bërë thirrje kryeministrit t'i shfrytëzojë mundësitë dhe ekspertizën që kjo platformë ofron.

Në adresimin e tij, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, prezantoi parimet dhe objektivat e qeverisë lidhur me procesin e dialogut me Serbinë. Lidhur me marrëveshjen e Uashingtonit ai tregoi hapat deri tek arritja e kësaj marrëveshje. Ai njoftoi se qeveria ka filluar përgatitjet për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit dhe në ditët në vijim do të përgatiten edhe planet për obligimet e ministrive përkatëse për zbatimin e kësaj marrëveshje. Ai theksoi se pret që një marrëveshje finale me

Serbinë mund të përmbyllet brenda muajve ose një viti. "Ajo që po bëjmë është se po diskutojmë për elementet e marrëveshjes finale, në përputhje me konventat ndërkombëtare. Nuk jemi duke arritur një marrëveshje parciale, por marrëveshje finale për njohje reciproke", ka theksuar Hoti.

Qëllimi i këtij procesi, sipas tij, është vetëm njohja reciproke dhe me Serbinë do të pajtohen për të gjitha çështjet ose nuk do të pajtohen fare. Pjesëmarrësit e pranishëm nga shoqëria civile në këtë tryezë ngritën çështjen e transparencës në dialog, hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem, Asociacionin e

Komunave me Shumicë Serbe, Ujmanin, kishën ortodokse, mini-shengenin dhe strategjinë e Kosovës në rast se nuk arrihet një marrëveshje finale me Serbinë. Kryeministri Hoti u zotua për transparencë të plotë ndaj Kuvendit, shoqërisë civile dhe publikut të gjerë dhe bëri thirrje publike për organizatat e shoqërisë civile për t'u bërë pjesë e ekipeve të ekspertëve të qeverisë mbi çështjen e dialogut. Ky diskutim organizohet në kuadër të projektit "Promovimi i një procesi të mirë informuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi" i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada Gjermane në Kosovë.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të "Platformës së shoqërisë civile për dialogun" ka mbajtur diskutim me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të medias. Në hapjen e tryezës, Jeta Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, bëri një përmbledhje të zhvillimeve të fundit lidhur me procesin e normalizimit të marrëdhënieve duke theksuar që mbeten ende shumë pikëpyetje rreth tij. Ajo shtoi se mungesa e konsensusit politik në vend po vazhdon ta shoqërojë procesin e dialogut me Serbinë, ndërsa mungesa e transparencës mbetet problematikë e cila duhet adresuar. Gjithashtu, ajo ngriti

çështjen e zbatimit të marrëveshjes së Uashingtonit si dhe procesin e ndërmjetësuar nga BE.

Leonora Kryeziu, drejtoreshë ekzekutive e PIPS, prezantoi "Platformën e Shoqërisë Civile për Dialog", ku tha se kjo platformë erdhi si nevojë për ta freskuar procesin e rinisur të dialogut, duke e përafuar qytetarin me zhvillimet në dialog. Ajo shtoi se platforma është themeluar si një iniciativë e përbashkët e organizatave dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile të profileve të ndryshme, duke përfshirë edhe aspektin etnik. Ndërsa si synim, ndër të tjera, ka promovimin e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Kryeziu, ndër të tjera, tha se "dallimet në demokraci mund të jenë të frytshme, por jo antagonizmat e



PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA REAGUAR PËR PROCESIN E DIALOGUT TË BRUKSELIT

THAÇI: KUVENDI T'IA NDALOJË KRYEMINISTRIT TË NEGOCIOJË PËR ÇËSHTJE TË BRENDSHME TË KOSOVËS

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar Qeverinë e Kosovës që të mos i hapë çështjet e brendshme me Serbinë në dialogun e Brukselit. Ai ka thënë se hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin është fillim i instalimit të republikës serbe në Kosovë. I pari i shtetit ka ftuar urgjentisht Kuvendin ta votojë një rezolutë përmes së cilës kryeministrit i ndalohet të negociojë për çështje të brendshme. Në anën tjetër, kryeministri Avdullah Hoti ka mohuar se do të diskutohet për një gjë të tillë në Bruksel

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave me shumicë serbe në dialogun e

Brukselit është gabim shumë i rrezikshëm i Qeverisë së Kosovës. Përmes një deklarate për media, ai ka vlerësuar se një gjë e tillë është goditje ndaj shtetësisë dhe cenim i sovranitetit të shtetit. Sipas Thaçit, këto tema janë adresuar dhe zgjidhur në kuadër të Pakos së Ahtisaarit. "Hapja e temave

për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave serbe në dialogun e Brukselit është gabim i madh dhe shumë i rrezikshëm i Qeverisë së Kosovës. Është goditje ndaj shtetësisë dhe cenim i sovranitetit të shtetit tonë. Këto tema janë adresuar dhe zgjidhur në kuadër të Pakos

së Ahtisaarit, e cila i parapriu shpalljes së pavarësisë, por edhe në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit në prill të vitit 2013 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, askush nuk ka mandat që të bisedojë në emër të Kosovës për tema të mbyllura, në Bruksel apo kudoqoftë. Kosova nuk mund dhe me asnjë çmim asnjëherë nuk do të lejojë që brenda territorit të saj të krijohet një entitet politik, i cili do të ishte riprodhim i Republikës Serbe në territorin e Kosovës", ka deklaruar presidenti Thaçi. Ai ka vlerësuar se diskutimi për asociacionin është fillim i instalimit të Republikës serbe në Kosovë. "Diskutimi për

asociacionin nesër në Bruksel është fillim i instalimit të Republikës Serbe brenda Republikës së Kosovës, ndërsa diskutimi për pronat e Kosovës me Serbinë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, si dhe është cenim i sovranitetit të shtetit tonë", ka thënë Thaçi, duke e ftuar urgjentisht Kuvendin e Kosovës ta votojë një rezolutë, me të cilën kryeministrit i ndalohet të negociojë për çështje të brendshme. "Kuvendi i Kosovës urgjentisht duhet ta trajtojë këtë hap të rrezikshëm të Qeverisë së Kosovës në dialogun e Brukselit. Po ashtu, urgjentisht duhet ta votojë edhe një rezolutë, me të cilën

S'ka koordinim të institucioneve për dialogun e Brukselit

Këshilltari i presidentit Hashim Thaçi, Adil Behramaj, ka konfirmuar se nuk ka bashkëpunim mes kryeministrit dhe presidentit, e as bashkëpunim qeveri-opozitë lidhur me dialogun apo marrëveshjen e re. "Në fakt, kryeministri dhe klubi i valltarëve të tij janë kah e bëjnë situatën shumë shqetësuese. Nuk ka unitet brenda qeverisë. Nuk ka kurrfarë bashkëpunimi mes kryeministrit dhe presidentit. Nuk ka kurrfarë bashkëpunimi në mes të qeverisë dhe opozitës", ka shkruar Behramaj në profilin e vet në "Facebook".

Ai ia ka kujtuar qeverisë se nuk i ka në përbërje as 40 deputetë shqiptarë. "Mungesa e kohezionit të brendshëm, ku 40 vota shqiptare nuk dihet nëse i ka kjo qeveri dhe fati i çdo vendimi të saj varet ekskluzivisht nga Lista Serbe. për çdokënd që i kupton pak këto procese do të duhej të ishte shumë shqetësuese. Po ashtu, mungesa absolute e përkrahjes opozitare, sipas së cilës, kryeministri me 25 mijë vota dhe qeveria e tij nuk kanë fare legjitimitet të na përfaqësojnë, se lëre më edhe të nënshkruajnë marrëveshje të rëndësishme për fatin e Kosovës, sërish do të duhej të ishte shqetësuese", ka shkruar ai, duke shtuar se nga 2014-ta Kosova është në qorrsoqak politik për shkak të këtyre aventurave të papërgjegjshme politike.

Një ditë më parë kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, e ka potencuar të domosdoshme nevojën për transparencë të plotë përgjatë tërë këtij procesi, e sidomos për respektimin e zotimeve të dhëna para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës. Sipas Osmanit, nuk ka alternativë tjetër përpos dialogut, mirëpo është gabim serioz që po hapen çështje tashmë të mbyllura ndër vite si dhe po diskutohen çështje të rregullimit të brendshëm që tashmë janë shpallur jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në vend. "Legjitimiteti, përgatitja, përvoja dhe arritja e unitetit politik janë formula e vetme për sukses në dialog", ka deklaruar ajo.

Dialogu në mes të palëve në Bruksel është ripërtërirë më 16 korrik dhe ai po ndërmerretësohet nga Bashkimi Evropian. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar për herë të dytë më 7 shtator. Me këtë rast, sipas deklaratave të të dyja palëve, janë hapur temat për asociacionin e komunave me shumicë serbe, për pretendimet e përbashkëta financiare dhe pronësore, ndërkaq janë harmonizuar qëndrimet lidhur me çështjen e të pagjeturve, personave të zhvendosur si dhe për bashkëpunimin ekonomik. Temat që ata përcaktojnë diskutohen më tej nga ekipet e ekspertëve të të dy vendeve.

Nis 'Java e sigurisë rrugore', bëhet thirrje për siguri në trafik



PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, në shenjë të shënimit të javës së Sigurisë Rrugore e cila manifestohet në mbarë Evropën, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi dhe drejtori i përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj, kanë nënshkruar premtimin/betimin për respektimin e rregullave të trafikut me qëllim për ta përçarur mesazhin tek opinioni.

Duke pasur parasysh që "Java e sigurisë rrugore" fillon nga data 16 shtator deri më 22 shtator, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Infrastrukturës, në këtë rast Departamenti i Këshillit Koordinues për Siguri në Trafikun Rrugor dhe Policia e Kosovës, janë zotuar karshi mekanizmave ndërkombëtarë, që do t'i inkurajojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për plotësimin e këtij premtimi/betimi, për të arritur një siguri më të madhe në trafik

e cila do të ndikojë në uljen e aksidenteve në trafik. "Institucionet e Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës, mbeten të përkushtuara për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi ligjore që kanë për qëllim sigurinë rrugore dhe njëkohësisht iu bëjnë thirrje të gjithë qytetarëve, në veçanti pjesëmarrësve në trafik, që të jenë pjesë e nënshkrimit të këtij premtimi/betimi si dhe të respektojnë dhe njëherësh zbatojnë rregullat e trafikut", ka njoftuar Policia e Kosovës.

LV-ja: Moratoriumi për anëtarësim në organizata ndërkombëtare do t'i shkaktojë dëme Kosovës



PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka vazhduar ta kritikojë kryeministrin Avdullah Hoti për marrëveshjen e Uashingtonit, konkretisht për pikën 15 të marrëveshjes e cila ka të bëjë me pezullimin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Deputetja e LV-së, Fitorë Pacolli, në një konferencë për media ka thënë të mërkurën se me këtë veprim Kosova hoqi dorë nga shtetësia e saj. "Ky zotim vuri në pah gatishmërinë e kësaj qeverie jolegjitime që të suspendohet nga anëtarësimi në organizata

ndërkombëtare. Do t'i shkaktoj dëme Kosovës ky moratorium. Në pikën e parafundit të marrëveshjes theksohet kjo. Pra, kemi një kryeministër ilegal që bëri shkelje kushtetuese. Është precedent i pashembullt", ka deklaruar Pacolli. Ajo ka thënë se nuk ka asnjë shtet që ka marrë vendim për ndalimin e aktiviteteve për anëtarësim. "Është tejet me rëndësi për shumë fusha, e sidomos për të ndikuar te shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Pse tani? Procesi i forcimit të shtetit të Kosovës për anëtarësim ka degraduar, madje edhe në anë-

tarësim me fusnotë. Ndërsa tani kemi hequr dorë plotësisht. E para reduktio anëtarësimin e Kosovës me fusnotë si dhe bllokoj Kosovën në shumë dimensione", ka thënë Pacolli. Sipas saj, Kosova me vetëdëshirë nuk do të aplikojë në organizata ndërkombëtare, përfshirë këtu OBSH-në e UNESCO-n. Pacolli ka deklaruar se anëtarësimi i Kosovës ka të bëjë edhe me interesat e partnerëve ndërkombëtarë, kurse zyrtari tjetër i LV-së, Enver Dugolli, ka deklaruar se qeveria Hoti është e padijshme.

kryeministrit i ndalohet të negociojë për çështje të brendshme të Kosovës dhe për tema që rrezikojnë rendin e brendshëm shtetëror", ka thënë presidenti.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka mohuar se në Bruksel do të diskutohet për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Në kuadër të "Platformës së shoqërisë civile për dialogun" të organizuar nga KDI-ja, Hoti është zotuar se marrëveshja e asociacionit të komunave me shumicë serbe nuk do të rihapet. "Nuk diskutohet dhe nuk hapet marrëveshja e arritur më herët për asociacionin", ka deklaruar Hoti.

Madje ai ka mohuar çdo mundësi që kjo çështje të hapet të enjten në takimin mes ekspertëve të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. "Nesër nuk diskutohet për asociacionin dhe nesër nuk është ditë e rrezikshme për Kosovën. Nesër është një ditë e zakonshme ku kryeministri i vendit raporton para deputetëve të Kuvendit të Kosovës", ka vlerësuar Hoti.

Kryeministri Hoti ka shtuar se metodologjia e negociatave është ndërtuar në format të tillë që secila palë propozon temat e diskutimit. Ai ka deklaruar se çështja që do të diskutohet në takimin e radhës në Bruksel janë obligimet financiare në mes të dy vendeve, ku përfshihen çështja e pensioneve, suksesioni i pasurisë së ish-Jugosllavisë, borxhi publik i ish-Jugosllavisë, dëmet e luftës dhe një sërë çështjesh të tjera brenda kësaj kategorie.

SBASHK-u: Institucionet mos ta lexojnë gabimisht përkushtimin tonë

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka thënë se, përkushtimin për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të këtij viti shkollor, që vlerësohet nga më të vështirët deri më tani, mos ta lexojnë gabimisht institucionet lokale dhe qendrore. “Është e vërtetë se SBASHK-u në takimet me MASH-in dhe me institucione të tjera është zotuar se do ta vazhdojë komunikimin me punëtorët e arsimit dhe do t’u japë kurajë atyre që ta vazhdojnë përkushtimin në rrjedhën e mbarë të këtij viti shkollor, po ashtu SBASHK-u është zotuar që moti se do të mbetet në mbrojtje të anëtarësisë dhe do të vazhdojë të mbetet zë i kërkesave të tyre”, thuhet në komunikatën e këtij institucioni.

SBASHK-u kë bërë me dije se në bashkëbisedat e vazhdueshme me ministrin Ramë Likaj janë pajtuar që duhet t’u bëhet zgjidhje



punëtorëve të arsimit të sëmure rëndë në mënyrë që ata mos angazhohen në procesin mësimor, por të zëvendësohen me kuadro të tjera për këtë vit shkollor dhe që të sigurohet buxhet shtesë për norma shtesë ngaqë, sipas SBASHK-ut, natyra e punës në këto kushte pandemie do të bëjë që një numër mësimdhënësish të jenë të

ngarkuar me më shumë orë pune krahasuar me normat që i kanë të përcaktuara me ligj dhe me Kontratën Kolektive të arsimit të Kosovës. “Ministri Likaj ka ngritur këto çështje edhe në qeveri dhe e përgëzojmë që ka arritur të bëjë zgjidhje duke siguruar buxhet për t’u dhënë paga kolegëve tanë të sëmure rëndë. Mirëpo informacionet nga

terreni flasin se DKA-të dhe drejtoritë e shkollave nuk janë duke i trajtuar këto çështje me personelin arsimor dhe se kolegët tanë të sëmure, krahas stresit nga sëmundja, janë vënë në siklet sepse nuk u është komunikuar me vendime se janë të liruar nga procesi mësimor dhe se do ta marrin pagën deri në një vendim tjetër”, thuhet në

komunikatën e SBASHK-ut. Po sipas SBASHK-ut, drejtoritë e shkollave dhe DKA-të duhet të komunikojnë me personelin arsimor dhe t’ua bëjnë me dije se për angazhime shtesë do të kompensohen dhe për këtë edhe t’u lëshohen vendime. “Një komunikim i tillë duhet bërë edhe me psikologët, pedagogët e personelin tekniko-ndihmës sepse edhe për këto profile MASH-i ka arritur të sigurojë mbështetje buxhetore për norma shtesë”, thuhet në këtë komunikatë. SBASHK-u ka vlerësuar se duke pasur shumë ankesa nga kolegët e tyre nga kryeqyteti, edhe një herë i drejtohet DKA-së në Prishtinë, që mos të insistojë në zbatimin e E-shkollorit sepse edhe ashtu, ky është vit i vështirë shkollor dhe mësimdhënësit kanë mjaft angazhime në përpjekjet për ta realizuar si duhet procesin edukativ e arsimor në kohën kur edhe orët mësimore janë shkurtuar dhe angazhim kyç i mësuesit le të jetë procesi mësimor dhe përpjekja që nxënësit të arrijnë njohuri të reja.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit dhe Ministrisë së Mbrojtjes



Prishtinë, 16 shtator (ER) - Në ambientet e Kuvendit të Kosovës është mbajtur ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në prani të komandantit të FSK-

së, gjeneraljtënant Rrahman Rama dhe autoriteteve të tjera të larta nga dy institucionet respektive, marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit e nënshkruan ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa

Osmani-Sadriu. Sipas kësaj marrëveshje, ministri i Mbrojtjes në koordinim me komandantin e FSK-së emëron oficerin, zyrtarin ndërlidhës legjislativ në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, me

qëllim të rritjes së bashkërendimit dhe komunikimit për përmbushjen dhe realizimin e detyrave kushtetuese dhe ligjore. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, kryetarja Osmani, ministri Quni dhe gjeneral Rama

shprehën gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm në të gjitha fushat e interesit të ndërsjellë. Në përmbyllje të ceremonisë, ministri Quni prezantoi para kryetares Osmani oficerin ndërlidhës, kapiten Manushaqe Nura.

GLPS-ja: Qeveria Hoti u bë kabineti me numrin e dytë më të lartë të zëvendësministrave në Kosovë

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur një konferencë për media të mërkurën, me temë "Vlerësimi i 100 ditëve të para të qeverisë Hoti". Sipas GLPS-së, me emërimin e 46 zëvendësministrave, qeveria Hoti u bë kabineti me numrin e dytë më të lartë të zëvendësministrave në Kosovë në 13 vjetët e fundit. GLPS-ja ka theksuar se kabineti i qeverisë Hoti karakterizohet edhe me pabarazi të lartë gjinore si në pozitat ministrore, po ashtu edhe në pozitën e zëvendësministrit

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka organizuar sot konferencë për media me temë "Vlerësimi i 100 ditëve të para të qeverisë Hoti". Duke marrë parasysh se qeveria Hoti sapo ka kaluar 100-ditëshin e parë të qeverisjes, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, përmes një analize politikash, ka vlerësuar performancën e kësaj qeverie.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka vlerësuar madhësinë dhe funksionimin e qeverisë Hoti. Sipas GLPS-së, përkundër faktit që në planin e saj elektoral LDK-ja ka premtuar qeveri të vogël me 12 ministri dhe 24 zëvendësministra, e njëjta ka përfunduar duke dyfishuar numrin e zëvendësministrave (përkatesisht nga 24 në 46), si dhe ka shtuar dy ministri në krahasim me qeverinë e kaluar. "Me emërimin e 46 zëvendësministrave, qeveria Hoti u bë kabineti me numrin e dytë më të lartë të zëvendësministrave në Kosovë në 13 vjetët e fundit. Rritja e numrit të zëvendësministrave nuk ndoqi ndonjë logjikë qeverisjeje, por ajo u përdor më së shumti për t'i kënaqur apetitet e partnerëve të koalicionit. Kështu, ka ministri, si Ministria e Kulturës dhe Ministria e Ekonomisë, që kanë nga pesë zëvendësministra, arsyeshmëria e ekzistencës së të cilëve asnjëherë nuk është arsyetuar siç duhet", theksohet në vlerësimin e GLPS-së.

GLPS-ja ka theksuar se kabineti i qeverisë Hoti karakterizohet me pabarazi të lartë gjinore si në pozitat ministrore, po ashtu edhe në pozitën e zëvendësministrit. "Nga gjithsej 16 ministra, ka vetëm tri gra në këtë pozitë, kurse nga 46 zëvendësministra, vetëm tetë janë gra", thuhet në komunikatën e GLPS-së. Grupi për Studime Juridike dhe

Politike ka theksuar se koalicioni qeverisës ka shpërfaqur një dobësi serioze të funksionimit të brendshëm, me mungesë të konsensusit për çështje bazike siç janë politika e jashtme, dialogu, apo edhe mënyra e shpenzimit të buxhetit sikur që është rasti i financimit të ndihmës juridike për të akuzuarit e Gjykatës Speciale. "Mungesa e konsensusit të brendshëm është, gjithashtu, e vërejtshme sa i përket rolit të kryeministrit në procesin e dialogut, meqenëse së paku një nga partnerët e koalicionit ka kundërshtoi mbi diskrecionin e tij për ta ushtruar funksionin epror sipas kompetencave kushtetuese. Koalicioni, gjithashtu, po dëshmon një shpërqendrim të theksuar sa i përket agjendës qeveritare në shumë fusha, siç janë arsimit, shëndetësia, investimet publike etj. Ka një tendencë të vazhdueshme të partnerëve më të vegjël të koalicionit për të shtyrë vendime të anshme politikisht dhe që eventualisht përbëjnë tendencë klienteske ndaj elektorateve të tyre", theksohet në komunikatën e GLPS-së.

Më tutje në këtë komunikatë të vlerësimit të 100-ditëshit të qeverisë Hoti thuhet se për shkak të mungesës së një shumice parlamentare, qeverisë iu deshën dy muaj për ta miratuar rishikimin e buxhetit, për të ekzekutuar pagesa nga pakoja e emergjencës, për t'i ratifikuar kreditë ndërkombëtare dhe për t'i elaboruar politikën e paketës së rimëkëmbjes. "Qeveria nuk ka ofruar ende një perspektivë të qartë qeverisëse ndaj disa sferave të sektorit publik, si: çfarë do të ndodhë me ligjin e ri të pagave? Si do të financohen projektet e infrastrukturës publike dhe mbi çfarë kriteresh do të zbatohen ato? A do të ketë një sistem merite për emërimin në pozita të larta, sidomos në fushat siç janë ndërmarrjet publike apo agjencitë ekzekutive", thuhet në këtë komunikatë.



Qeveria Hoti dhe sundimi i ligjit

"Qeveria ka dëshmuar një mungesë serioze të agjendës në fushën e sundimit të ligjit; nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë që realisht ka kontribuar në çkapjen e institucioneve nga politika. Për më tepër, kthimi në detyrë i disa sekretarëve të përgjithshëm që kanë pasur probleme me kredibilitetin e tyre ligjor është gjithashtu problematik. Iniciativa e zhvendosjes së vetingut nga prioriteti në një aktivitet anësor është tejet shqetësuese. Për më tepër, plani i Ministrisë së Drejtësisë për të hartuar pa

ndonjë nevojë një reformë në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë vetë krerët e këtij sistemi, është një paradoks", thuhet në vlerësimin e GLPS-së.

Më tej, thuhet se emërimi i figurave të larta të sistemit të drejtësisë në Komisionin e Jurisprudencës është qartazi tendencë klienteliste dhe dëshmon qartazi konceptin kapës ndaj sistemit të drejtësisë; nuk ka një plan të qartë antikorrupsioni dhe një gjë e tillë nuk përbën aspak prioritet qeveritar. Gjithashtu, GLPS-ja thekson se qeveria nuk ka dëshmuar ndonjë masë për t'i zvogëluar shpenzimet, për t'i sanksionuar të korruptuarit, për ta reformuar administratën publike etj.

Menaxhimi i pandemisë Covid-19

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka theksuar se gjatë njëqind ditëve të para të qeverisë Hoti Kosova ka qenë një nga vendet më vdekjeprurëse në botë nga koronavirusi. "Numri i pamjaftueshëm i testeve, mungesa e gjurmimit të kontakteve, strategjia e mangët e komunikimit, mungesa e kontroleve të çmimeve për ilaçet janë disa nga vendimet që çuan në numrin e lartë të infeksioneve dhe vdekjeve gjatë 100 ditëve të para. Qeveria dështoi të sigurojë dhe subvencionojë testimin për popullatën e përgjithshme duke kufizuar testimin vetëm për njerëzit me simptoma të forta dhe teste selektive të figurave publike. Shumë të tjerë me simptoma më të lehta nuk mund të testohen fare. Për shkak të numrit të lartë të rasteve, gjurmimi i kontaktit ra plotësisht, duke e bërë të vështirë gjurmimin e vatrave të reja të infektimit", thuhet në këtë vlerësim të GLPS-së.

Qeveria Hoti, dialogu me Serbinë dhe politika e jashtme

Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka dhënë një vlerësim edhe sa i përket dialogut me Serbinë dhe politikën e jashtme. GLPS-ja mendon se qeverisë Hoti i mungon një platformë për dialogun me objektiva dhe qëllime konkrete rreth konkludimit të procesit.

Thuhet se rifillimi i dialogut është shoqëruar me mungesë transparence nga ekipi i Kosovës. Rezultatet nga takimet e para janë të paqarta, nuk ka transparencë nga takimet në Bruksel dhe ato në Uashington. "Shpesh ka pasur një ndarje brenda koalicionit qeverisës për dialogun në përgjithësi. Qeveria Hoti ka dështuar të krijojë unitet, koordinim të partive politike për çështjen e dialogut me Serbinë dhe konsensus të përgjithshëm të spektrit politik. Në anën tjetër, Ministria e Punëve të Jashtme ka kthyer praktikën e dëmshme diplomatike të cilat vazhdojnë të jenë rezultat i politizimit, nepotizmit, në shërbim të interesave të ngushta dhe në dëm të efikasitetit dhe kontributit të përfaqësuesve diplomatikë të Kosovës", bëhet me dije në këtë vlerësim të GLPS-së.

Krasniqi vizitoi 'Sharrcem'-in, interesohet për prodhimin e çimentos në këtë fabrikë

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka vizituar fabrikën për prodhimin e çimentos "Sharrcem" në Han të Elezit. Krasniqi ka bërë me dije se pas nënshkrimit të marrëveshjes me MSA-në janë përgatitur ligje që u mundësojnë bizneseve që prodhojnë produkte ndërtimore t'i plasojnë edhe në tregun e jashtëm



Në këtë takim me drejtorin teknik dhe stafin e tij është biseduar për mundësitë ligjore për prodhuesit dhe investitorët,

ku ministri Krasniqi ua ka ofruar mbështetjen që prodhimet e Kosovës të jenë pjesë edhe e tregut ndërkombëtar dhe të jenë

konkurrentë sa i përket cilësisë. "Sharrcem" aktualisht përmbush më shumë se 50 për qind të tregut të Kosovës.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, së bashku me inspektorët e tregut, ka vizituar të mërkurën fabrikën për prodhimin e çimentos, "Sharrcem", në Han të Elezit. Ministri Krasniqi është pritur nga drejtuesit e kësaj fabrike me të cilët ka biseduar për kushtet e punës, për tregun dhe ndikimin e pandemisë në prodhim. Ministri Krasniqi ka thënë se pas nënshkrimit të marrëveshjes me MSA-në janë përgatitur ligje që u mundësojnë bizneseve që

prodhojnë produkte ndërtimore t'i plasojnë edhe në tregun e jashtëm. "Kemi nxjerrë edhe udhëzimin administrativ, pikërisht për çimenton dhe sot nga afër menaxhmenti i kësaj kompanie na njoftoi se ka filluar së zbatuari dhe po i hap shumë mundësi dhe lehtësira për plasmanin e produktit të tyre në treg", ka thënë Krasniqi. Kurse drejtori teknik i "Sharrcemi"-it, Behar Disha, ka falënderuar ministrin për vizitën dhe e ka informuar për punët dhe funksionimin e fabrikës. "Ministri nga afër e ka parë procesin e prodhimit dhe funksionimin deri në paketim për shitje", ka thënë ai.

Kërkohet që industria e prodhimit të shpallet sektor i rëndësishëm nacional



PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Kryetari i Bordit i Klubit të Prodhuesve, Bashkim Osmani, së bashku me ekzekutivin e Klubit të Prodhuesve, është takuar të mërkurën me kryetaren e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani. Arsyja e takimit ishte diskutimi mbi gjendjen e tanishme të sektorit të prodhimit dhe avokimi për ndërmarrjen e disa masave të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në përmirësimin e kësaj gjendje. Kryetari Bashkim Osmani ka

falënderuar kryetaren e Kuvendit për pritjen dhe ka shprehur brengat e tij për sfidat me të cilat po përballen prodhuesit gjatë kohës së pandemisë, por edhe kërkesat e tyre për rimëkëmbje nga kjo gjendje. Sipas tij, është tejet i domosdoshëm miratimi i menjëhershëm i pakos emergjente të rimëkëmbjes, e cila do t'i ndihmonte shumë prodhuesit vendorë, ku shumë prej tyre janë në prag të mbylljes së veprimtarisë. "Prandaj është koha e fundit që kjo pako të

miratohet dhe të fillojë implementimi i saj, duke krijuar lehtësirat e parapara për ekonominë", ka thënë ai. Gjithashtu, Osmani ka kërkuar nga kryetarja e Kuvendit që ta mbështesë edhe Rezolutën e Prodhimit, ku Klubi i Prodhuesve me anë të kësaj rezolute kërkon që industria e prodhimit të shpallet sektor i rëndësishëm nacional, ku Qeveria e Kosovës do të duhej t'i përkrahte ndërmarrjet prodhuese, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të

tyre. "Po ashtu, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës do të duhej që rimëkëmbjen ekonomike të vendit ta bazojnë në fuqizimin e industrisë së prodhimit, si zgjidhjen e vetme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik", ka thënë kryetari i Bordit i Klubit të Prodhuesve, Bashkim Osmani. Gjatë takimit me kryetaren Vjosa Osmani u përmend edhe iniciativa për prokurim publik, ku Klubi i Prodhuesve i Kosovës kërkon nga institucionet

shtetërore dhe ato publike që në procedurat e tenderimit këto institucione ta fusin si kriter edhe prodhimin vendor, gjë që do t'i mbështeste prodhuesit gjatë kësaj krize dhe do të ndihmonte në rimëkëmbjen e tyre. Kryetarja Osmani i falënderoi përfaqësuesit e Klubit të Prodhuesve për vizitën dhe shprehu gatishmërinë që të përkrahë këtë rezolutë, por edhe iniciativat e tjera, duke u qëndruar pranë prodhuesve.

Kryeshefja e Postës së Kosovës takohet me ambasadorin zviceran

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Ushtruesja e detyrës e kryeshefes ekzekutive të Postës së Kosovës, Vjollca Shala-Mulaj, e shoqëruar nga bashkëpunëtorët, është takuar të mërkurën me ambasadorin e Zvicrës në

Kosovë, Thomas Kolly. Në këtë takim u bisedua për sfidat dhe projektet e Postës së Kosovës si dhe për mundësitë që Ambasada e Zvicrës në Kosovë ta mbështesë këtë ndërmarrje në të ardhmen. U. d. kryeshefja, Shala-Mulaj,

ka falënderuar ambasadorin Kolly dhe drejtoreshën e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCOK) për ndihmën që i ka dhënë Postës së Kosovës gjatë kohës së pandemisë Covid-19.



Serbia po shkel marrëveshjen e CEFTA-s dhe atë të Brukselit

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Shkelja e marrëveshjes së CEFTA-s dhe asaj të Brukselit nga ana e Serbisë gjatë qarkullimit të mallrave nga Bashkimi Evropian transit për në Republikën e Kosovës, duke detyruar bizneset e Kosovës që të regjistrohen dhe paguajnë taksa në Serbi, shqetësimet e bizneseve për mospërfshirje të shumicës së rekomandimeve në pakon e rimëkëmbjes, ishte temë e diskutimit që Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) kishte me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi.

Me këtë rast, OAK-u do t'i drejtohet me një letër njoftim edhe BE-së, duke i treguar se Serbia nuk është duke respektuar marrëveshjet e nënshkruara deri më tani. Lidhur me këtë çështje si dhe problemet me Ligjin për Tregti të Brendshme, vendimi për ndalimin e importit të vajit të palmës, rastin e biznesit "Trofta", duke mos pasur mundësi të eksportit të peshkut në Maqedoninë e Veriut, rast ky i cili është aktiv për më shumë

se një vit dhe ende nuk ka marrë zgjidhje definitive si dhe çështjes së vendosjes së flamujve për të gjitha produktet, ishin problemet të cilat OAK-u i shpallti para ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi.

OAK-u ka ngritur si çështje tjetër shqetësuese edhe nevojën që Ligji për Tregti të Brendshme të diskutohet me palët e interesit dhe të shkojë sa më parë në Kuvend Ligji për investime strategjike dhe heqja e detyrimit për pagesën e TVSH-së për blerjen e lëndës së parë brenda vendit.

OAK-u ka shprehur shqetësim se në rast se nuk përkrahet me urgjencë biznesi, zvogëlimi i numrit të punëtorëve do të jetë i pashmangshëm.

Anëtarët e bordit, Lulzim Begaj dhe Arsim Selmonmusaj, kërkuar sqarime shtesë nga ministri Veseli rreth vendimit për ndalimin e importit të vajit të palmës si dhe çështjes së vendosjes së flamujve në artikuj te marketet, duke pasur parasysh se taksa tashmë është larguar.

Ministri Veseli ceku se disa nga kërkesat tona tashmë i kanë



adresuar dhe janë duke pritur përgjigje. Sa iu përket problemeve me transportin e mallrave nëpër Serbi, Krasniqi ka pohuar se do të bëjë një reagim institucional për këtë çështje. Përdërisa për vendimin e fundit që ndalon përkohësisht

importin e vajit të palmës, ministri Krasniqi ka shpjeguar në detaje se përse është marrë ky vendim i cili gjithsesi është i përkohshëm, por ka për qëllim që t'i mbrojë bizneset dhe prodhuesit e përgjegjshëm. Në këtë takim OAK-u u përfaqësua

nga kryetari i saj, Skënder Krasniqi, nënkryetari i bordit Arsim Selmonmusaj, anëtar i bordit Lulzim Begaj, koordinatori Qëndresa Ibrahim dhe Fjolla Smaili, zyrtarë për marrëdhënie me publikun.



Hungaria, model i zhvillimit ekonomik për Kosovën

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, është takuar në Budapest me kryetarin e Odës Ekonomike dhe Industrisë të Hungarisë, Attila Galambo, ku temë diskutimi ishte bashkëpunimi ekonomik në mes të Kosovës

dhe Hungarisë. Shahini në Hungari ka prezantuar tregun ekonomik dhe inventiv të Kosovës si mundësi e madhe dhe inovative për investitorët hungarezë të cilët janë të mirëpritur edhe nga bizneset dhe institucionet e Kosovës. Ai ka thënë se modeli i

zhvillimit ekonomik i Hungarisë është model i mirë. Kurse Attila Galambo, kryetar i Odës Ekonomike të Hungarisë, ka njoftuar për mundësitë e bashkëpunimit me Kosovën dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor edhe në këtë kohë të pandemisë.

Në këtë takim u tha se bizneset duhet t'i kalojnë vështirësitë e kohës duke rritur bashkëpunimin pa barriera për investitorët e EU-së. Të dyja palët u morën vesh për bashkëpunim dhe bashkërendim të përpjekjeve të bizneseve të të dyja vendeve.

Abrashi dhe Mustafa, memorandum për mbjelljen e pishave nëpër rrugët e Kosovës

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me ministrin e Bujqësisë, Besian Mustafa, për pyllëzimin dhe shtimin e sipërfaqeve gjelbëruese në sipërfaqet rreth autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale.

Qëllimi i këtij memorandum është pyllëzimi dhe shtimi i sipërfaqeve të reja gjelbëruese, që paraqesin interes për mjedisin dhe pyjet publike të Republikës së Kosovës dhe duke konfirmuar angazhimin institucional mes ministrive për arritjen e një prej objektivave, atij

për mjedis të pastër dhe të gjelbëruar.

Ministri Abrashi ka thënë se memorandum ka për qëllim realizimin e pyllëzimeve dhe shtimin e sipërfaqeve gjelbëruese, në sipërfaqet përreth autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale, të cilat janë nën menaxhimin dhe mbikëqyrjen e MI-së. Sipas tij, pyllëzimi shërben edhe për ruajtjen e autostradës nga shembja e dheut, por edhe për ruajtjen e ambientit.

Ndërsa ministri Mustafa ka bërë me dije se ky memorandum i shërben shumë edhe mbrojtjes së mjedisit, duke pyllëzuar rrugët e Kosovës.



Diskutohet për implementimin e projektit 'modernizimi i kadastrës' në Malishevë

MALISHEVË, 16 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe përfaqësuesit e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kanë biseduar për aktivitetet konkrete për implementimin e projektit "modernizimi i kadastrës" edhe në Komunën e Malishevës.

Ky projekt si aktivitet kryesor ka rindërtimin e informacioneve kadastrale, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, nga të

cilat mund të përfitojë edhe Komuna e Malishevës. Për këtë arsye, respektivisht, me qëllim të diskutimit rreth fushave të interesit të përbashkët, ku bashkëpunimi do të mund të konkretizohet edhe me identifikim të hapave konkretë, është mbajtur edhe ky takim mes kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, dhe kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, si dhe drejtorit të

Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastrë, Bashkim Krasniqi, me bashkëpunëtorë.

Në takim është diskutuar edhe për të gjeturat e raportit të monitorimit të punëve kadastrale të kryera nga Zyrat Kadastrale Komunale.

Në fund të dyja palët janë zotuar për bashkëpunim dhe përmbyllje të këtij projekti kompleks, por shumë i domosdoshëm për të ardhmen e qytetarëve tanë.



Ministrja Dumoshi i jep përkrahje maksimale projektit rinor në Gjilan

GJILAN, 16 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, në shtëpinë e rinisë në Gjilan të mërkurën kanë promovuar projektin "S'Duhani" të qendrës studentore "Kadri Zeka", që u dedikohet të rinjve në formën e vetëdijesimit kundër përdorimit të duhanit dhe ruajtjes së shëndetit. Haziri ka falënderuar ministrën Dumoshi për mbështetjen dhe vëmendjen që ka ndaj kulturës, sportit, veçanërisht rinisë së Gjilanit dhe Kosovës, e cila është e dëshmuar në gjallërinë dhe kontributin e madh që e jep në shoqëri. "Sot jemi mysafirë të Qendrës Studentore 'Kadri Zeka', e cila në një konkurrencë shumë të madhe ka arritur që të jetë përfituese me projektin 'S'Duhani'. Mos e pini duhanin sepse ka efekte të rrezikshme, pastaj pasoja të pashërueshme dhe njëkohësisht një imazh jo të mirë në shoqëri. Nga Gjilani kemi edhe katër fitues të tjerë në MKRS të programeve të OJQ-ve dhe në kuadër të



kësaj Komuna e Gjilanit ka bashkangjitur edhe fondin e vet prej 100 mijë eurosh, me qëllim të mbështetjes së projekteve që i dedikohen rinisë përmes OJQ-ve dhe qytetarëve në përgjithësi", ka thënë Haziri.

Në fjalën e saj, Vlora Dumoshi, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka theksuar se MKRS-ja është e përkushtuar që me mbështetje përmes granteve, subvencioneve dhe projekteve të ndryshme ta arrijë zhvillimin e qëndrueshëm të të rinjve në ndërmarrësi, në shoqëri, në arsimim dhe në të gjitha

fushat e tjera.

Projekti "S'Duhani", që është elaboruar nga Elitë Bardhi, parasheh vetëdijesimin e hershëm të rinisë, duke ofruar këshillat që nga moshat e reja të nxënësve e deri te studentët. Projekti është në tri pjesë të veprimit, përmes këshillave juridike, pedagogjike dhe psikologjike. Të gjithë të interesuarit pas këtij aktiviteti mund aplikojnë në uebfaqen e qendrës studentore "Kadri Zeka" dhe përzgjedhja bëhet në bazë të kriterëve të paraparur, për të vazhduar më pas me punëtoritë, në bazë të planit të punës.

Drenasi, komuna e parë për performancë, përfiton 803 977.35 euro

DRENAS, 16 SHTATOR (ER) - Drenasi mbetet komuna më transparente e llogaridhënës në shërbim të qytetarëve, duke u radhitur kështu në vendin e parë. "Pas publikimit të raportit të performancës së komunave për vitin 2019 nga Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal e financuar nga MAPL-ja, Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Ambasada Suedeze dhe Ambasada Norvegjeze, ku

kanë qenë 19 fusha të matjes me 119 tregues e që Drenasi në këtë matje në mesin e 38 komunave ka performuar në vendin e parë dhe si rezultat i kësaj ka fituar grant në vlerën prej 803,977.35 eurosh, disa keqdashës për zhvillimin e komunës dhe keqinterpretues, janë duke provuar ta devijojnë suksesin që ka Drenasi në performancën më të suksesshme në Kosovë", ka njoftuar komuna e Drenasit.



Gani Xhemajli, mësime online model që u ndoq nga mijëra nxënës në mësimet online gjatë pandemisë

FERIZAJ, 16 SHTATOR (ER) - Shembujt e mësimeve online të angazhuar gjatë pandemisë së virusit Covid-19 kudo në Kosovë janë të shumtë, mirëpo mësimeve të caktuar gjatë gjithë procesit kur shkollat ishin të zbrazëta e mësimi mbahej në distancë, bëjnë dallim. I tillë është edhe mësimeve online të mësimit të fizikës, Gani Xhemajli, njëko-


hësisht kryetar i Shoqatës së Fizikanëve në Ferizaj, i cili u prit të mërkurën në zyrë nga kryetari i komunës, Agim Aliu. Mirënjohës për punën e jashtëzakonshme që ka zhvilluar mësimeve online Xhemajli u shpreh i pari i Ferizajt, Agim Aliu. Ai ka thënë se shembujt e tillë duhet të shërbëjnë si model në mesin e mësimeve online të fizikës, mbi të gjitha,

spikasin përkushtimin, dashurinë dhe vullnetin e pashoq për të mbjellë dijen te nxënësit.

Në anën tjetër, mësimeve online i fizikës, Gani Xhemajli, ka theksuar se gjatë gjithë jetës së tij profesionale ka pasur një dhe vetëm një qëllim: atë të avancimit dhe konkretizimit të dijeve të nxënësve në fushën e fizikës.



Universitetet duhet të bëhen avangardë e integritit



Milazim KRASNIQI

Ngritja e një numri të madh të universiteteve publike në Shqipëri e në Kosovë, të ndjekura nga një numër edhe më i madh kolegësh dhe universitetesh private, tashmë ka krijuar një realitet të ri në arsimin e lartë ndër shqiptarë dhe ka hapur mundësi më të larmishme të arsimit të edukimit të brezave të rinj. Rritja e numrit të universiteteve dhe të kolegjeve ka shtuar numrin e studentëve, gjë që paraqet një hap të rëndësishëm në përmirësimin e statistikave negative lidhur me shkallën e arsimit të qytetarëve shqiptarë. Meqë procesi i ngritjes së universiteteve dhe i rritjes së numrit të studentëve ende është duke vazhduar, nuk mund të flitet për një tablo të qartë se si do të finalizohen këto dy procese dhe veçmas cilat do të jenë rezultatet e prekshme në zhvillimin shoqëror e ekonomik, po edhe në përparimin e demokracisë në këto dy shtete shqiptare. Por, tash për tash mund të thuhet se nëse numri i universiteteve dhe i kolegjeve është i madh dhe disa prej tyre nuk kanë arritur standardet e universiteteve të mirëfillta, numri i studentëve ende mbetet i vogël në krahasim me standardet evropiane. Fjala vjen, në Bashkimin Evropian planifikohet që deri në vitin 2020, së paku dyzet për qind e banorëve në moshave 30-34 vjeç të kenë një diplomë të arsimit të lartë. Kur kihet para sysh se ky projektion duhet të përlllogaritet në një popullsi prej pesëqind milionë banorësh, është e qartë se numri i planifikuar i të diplomuarve kap një shifër kolosale! Prandaj, në realitetet shqiptare, kjo shifër ambicioze sipas të cilës dyzet për qind të banorëve të moshave 30-34 vjeç duhet të kenë një diplomë universiteti deri në vitin 2020, me siguri është ende larg që të ëndërrohet. Por, që të zvogëlohet distanca e madhe, këto objektiva që vlejnjë në Bashkimin Evropian, qysh tash do të duhej të fillonin të promovoheshin edhe në politikën arsimore të Shqipërisë e të Kosovës. Për

mungesë statistikash të besueshme, është e vështirë që të dihet saktësisht numri i të diplomuarve në Shqipëri dhe në Kosovë dhe çfarë përqindjesh të popullsisë mbulojnë ato. Por, e vërteta që shihet edhe me sy është se ai numër është ende shumë i vogël. Rritja pak më e dukshme e numrit të studentëve të diplomuar ka filluar vetëm në këto dy-tri vitet e fundit, që do të thotë se kontingjentet më të mëdha të të diplomuarve pritet që të dalin në tregun e punës vetëm në vitet që vijnë. Por, kompensimi i mungesës së të diplomuarve në kontinuitet dhe veçmas në dy deceniet e shkuara, do të jetë shumë i ngadaltë. Ndërsa, për të ruajtur dinamikën e zhvillimeve të viteve të fundit, sa i përket numrit të studentëve të regjistruar, ky regjistrim duhet të liberalizohet në maksimumin e vet. Shifrat për tendencën e rritjes së numrit të studentëve në botë, që u paraqiten në konferencën vjetore të Shoqatës së Universiteteve Evropiane, janë impulsive: nga njëqind milionë studentë sa kishte në vitin 2000, parashikohet që në vitin 2030 të jenë katërqind milionë studentë, pra një katërfishim i numrit të studentëve në botë. Këtë trend duhet ta ndjekin edhe universitetet shqiptare të cilat duhet të planifikojnë rritjen e kapaciteteve akademike dhe të ambienteve për të përballuar rritjen e pritshme të numrit të studentëve, pa e dëmtuar cilësinë e studimeve. (Në të vërtetë, nëse kriteret e vlerësimit do të bëheshin më rigorozë, fjala vjen duke i bërë

vlerësimet me anën e komisioneve mikste e jo nga mësimdhënësit e lëndëve, as liberalizimi i maksimal regjistrimeve nuk do të rriste shifrat e të diplomuarve) Në sfondin e këtyre politikave dhe parashikimeve, dy gjëra duhet të shoqërojnë transformimin e këtij tregu të dijes që ende është në proces konsolidimi. E para, duhet të inkurajohet tendenca që disa nga këto universitete dhe kolegje, qoftë publike qoftë ato private, të integrohen mes vete, të bashkojnë kapacitetet dhe të bashkërendojnë planifikimet, në pajtim me tregun e punës, zhvillimin shoqëror e ekonomik të vendeve tona dhe politikën e integritimeve evropiane. Fuzionimi ose integrimi i disa universiteteve publike të vogla e provinciale, do të krijonte mundësi që studentëve t'u ofrohen studime më cilësore dhe që hulumtimi në kuadër të tyre të ishte më i motivuar edhe nga konkurrenca e brendshme. Natyrisht, mund të gjenden modelet më të përshtatshme për secilin rast veç e veç. Universitetet publike, që janë të ngritura në qytete të vogla provinciale, do të mund të fuzionoheshin në universitetet amë, atë të Tiranës dhe atë të Prishtinës, duke u shndërruar në "kampuse-satelite", po të shprehemi me një sintagmë që përdoret për të treguar mënyrën e funksionimit të universiteteve globale. Meqë në këtë rast nuk mund të vendoset shenja e barazisë ndërmjet konceptit të universitetit global dhe universiteteve amë (nëse do të bëheshin të tilla), po mjaftohemi të propozojmë që

të huazohet ky model nga universiteti global, sepse është lehtësisht i aplikueshëm dhe me siguri se do ta rriste nivelin e mësimdhënies e edhe do ta nxiste idenë e hulumtimeve në këto themelata. Kjo do të nënkuptonte edhe mobilitetin e mësimdhënësve brenda këtij sistemi, si edhe konvergjin e programeve. Ndërsa, motivi i integritit të kolegjeve dhe universiteteve private do të mund të ishte bashkimi i kapaciteteve ekzistuese të tyre për të promovuar konkurrencë më të fortë e më serioze me universitetet publike. Më një kesi koncepti, pra, të fuzionimit të disa universiteteve të vogla publike në universitetet e mëdha e me traditë, dhe me integrimin e disa kolegjeve dhe universiteteve private, do të zvogëlohej numri i tyre, por do të rriteshin kapacitetet akademike e të hulumtimeve, e prej këndeje edhe do të mund të rritej numri i studentëve të regjistruar. Praktika e disa viteve të fundit që të ngritën universitete publike të vogla në qytete provinciale, si dhe praktika e funksionimit të kolegjeve dhe universiteteve të vogla private gjithandej ku mund të ngrihet një kasolle, në dritën e trendeve të reja që po e përshkojnë botën universitare në Evropë e në botë, është e tejkaluar. Dhe është jokonkuruese. Një model i ri i bashkëpunimit të universiteteve nga vende të ndryshme, në bazë të parimit gjuhësor, (që tashmë është promovuar dhe ka filluar të jep rezultate) do të mund të aplikohet edhe në bashkëpunimin e universiteteve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Ky

model në sferën frankofone po testohet ndërmjet Universitetit të Gjenezës, Universitetit të Lirë të Brukselit dhe atij të Montrealit, ndërsa në sferën anglofonë ndërmjet Universitetit të Varvikut dhe një universiteti australian. Koncepti i këtij bashkëpunimi synon që të jetë më i thellë e më organik se sa një bashkëpunim rutinë ndërkombëtar, duke synuar edhe një shkallë të integritit strategjik. Universitetet shqiptare duhet po ashtu që të funksionalizojnë edhe bashkëpunime me universitete të huaja, që mundësojnë dhënie e diplomave të përbashkëta, sepse kjo i bën më atraktive në sytë e të rinjve, që duan të kenë një diplomë nga ndonjë universitet i jashtëm, për ç'arsye shumë sish (mund të jenë nga më të talentuarit) po ikin jashtë. Në këtë kontekst duhet të shikohet edhe çështja e studimeve online, sepse universitetet tona nuk mund të mbajnë ritmin në një konkurrencë gjithnjë e më të fortë, nëse nuk përshtaten me trendet dhe me strategjitë e reja. Për gjithë këto arsye, kur është fjala për arsimin e lartë dhe tregun e dijes, nuk mjafton të thuhet vetëm me fjalë se jemi të gatshëm për integrimet evropiane. Së paku në këtë fushë, përgatitja për të qenë konkurrues të njëmendët në përmasa evropiane, ende nuk ka ardhur në rend dite. Ndërsa, universitetet duhet të jenë avangardë e integritit, si në planin brendakombëtar, po ashtu edhe në atë evropian. (6 maj 2013, ribotim me shkas)





Kosova dhe Mustafa Kruja, një dyshe e përjetshme

Më poshtë mund ta lexoni një studim që analizon marrëdhëniet e veçanta që personazhi i shumë diskutuar i historisë shqiptare, Mustafa Kruja, pati me Kosovën dhe përpjekjet e tij të pafund për realizimin me çdo kusht të Shqipërisë etnike...

Nga: Eugjen MERLIKA

“E njoha në Shkup këtë fatos, kur në 1912, bashkë me ju e me Malsorët e vet ishte çue me lirue Shqipnën prej zgedhe të huej. E njoha e qysh atëherë s’na u danë zëmrat mâ prej shoqja-shoqes. Na bashkonte një ideal, ideali i Atdheut të dashtun. Për ket ideal ai e dha jetën si fatos, i tradhtuem në shpellën e Dragobis. Desht Beligradi me e shpëtue, me i a shpëtue jetën e me e peshue me pare: sall, të hiqte dorë prej luftës për lirin e Kosovës, sall të rrinte rahat në shtëpi të vet o ku t’i donte zëmra në tokë Jugosllave.

Ah, jo! Bajram Curri s’kish lë për t’a shitun Atdhën e vet. Tënë haznat e Beligradi, tënë Jugosllavija, tënë pasunija e botës s’e vyeshin për të lirin e një katundi të Kosovës. Mâ mirë me dekë. E diq si burrë, diq si fatos. Po ashtu diq në dhë të huej edhe nipi i tij qi nuk i qe dà kurrë në jetë të vet: Hysni

Curri, fatosi i Qafës së Prushit.

Nji tjetër gjakovas i ka hala sod eshtnat në mërgim, ku i dha fund jetës me dorë të vet tue lânë me shkrim këta dy rreshta të mallëngjyeshëm: “I mërzitun e i dëshpruem si nji njeri dyfish pa Atdhë, dava me i dhânë fund ksaj jete”.

Ky burrë, ky gjakovas i vërtetë, qe Niman Ferizi, nji tjetër mik i em qi më la mbas veti në nji moshë aqë të rë. E kur nji njeri e ka njohun Gjakovën nëpër ksi burrash, kur ai e din edhe tënë historin e këtij vendi, merret me mend se me ç’farë dashtunije e gzimi lakmon me e pà e me e përshëndetun”.

Këto ishin fjalët me të cilat, më 1 korrik 1942, Mustafa Kruja, atëherë Kryeministër i Shqipërisë së bashkuar nën pushtimin italian, mbas tridhjetë vitesh ndarje të detyruar, i u drejtua popullit të këtij qyteti, në të cilin ne sot jemi mbledhur për të përkujtuar 70-vjetorin e një ngjarjeje ogurzezë. A ka lidhje mes fjalëve të ish kryeministrit, drejtuar gjakovarëve, dhe

këtij simpoziumi që mbahet sot në këtë qytet, për të kujtuar me dhimbje, njëkohësisht me shpresë e besim në t’ardhmen, një nga ngjarjet më të hidhura, në mos më e hidhura e historisë së këtyre trojeve, të Kosovës e të Shqipërisë që prej një shekulli e këndeje?

Ajo ngjarje ishte ribashkimi i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare me Shtetin jugosllav. Ajo ngjarje shënoi fundin e “pranverës së Shqipërisë etnike”, që kaloi dhe u shua si një meteor i ndritshëm në qiellin e historisë shqiptare të shekullit të shkuar, për të lënë gjurmët e pashlyeshme në kujtesën historike të saj e në kujtesën vetiake të qindra mijëra shqiptarëve që u njëjtësuan me sendërtimin e ëndrrës së Shqipërisë së bashkuar në kufijtë e saj natyrorë. Mendoj se lidhja mes fjalimit të Krujës, apo vizitës së tij, i shoqëruar nga ministrat Vlora e Agushi dhe ngjarjes që përkujtojmë sot, është në vetë rendin e gjërave.

Ajo klasë politike që, n’atë rast, përfaqësohej prej tyre e që në curriculumin e saj, si stolinë më të çmuar, mbante firmat e vendosura në Dokumentin e Shpalljes së Mëvehtësisë shqiptare më 28 nëndor 1912, e kishte lidhur thelbin e veprimtarisë së saj politike, shoqërore e shtetërore me atë akt historik të prillit 1941, i cili sendërtonte, në një shkallë të kënaqshme, një ëndërr të

përkundur për tridhjetë vjet, atë të bashkimit të trojeve ku flitej gjuha shqipe në një shtet të vetëm. Ai synim, më se i ligshëm në një kontekst normal të marrëdhënies mes shteteve, u kthye në një ankth për shqiptarët që, brenda pak ditëve të tetorit të zi 1912, qenë të pranishëm në grabitjen me dhunë të trojeve të tyre shumë shekullore nga ana e fqinjëve, me të cilët ndanin një histori mijëvjeçare, me të mirat e të këqijat e saj.

Shteti i bashkuar i shqiptarëve, i pari në historinë e tyre të gjatë, i ngjau një zogu të sapodalë nga foleja që ra në pritën e gjahtarit të pashpirt, i cili e goditi befasisht, duke e rrëzuar për tokë të gjymtuar. Këtë zog të gjymtuar “Etërit e Kombit”, ata që i kishin nënshkruar Pavarësinë, duke pritur në duart e tyre lindjen e tij të vështirë, u munduan ta rrisin, t’i shërojnë plagët e ta bëjnë të fluturojë, me fuqitë e tij, drejt synimesh të larta zhvillimi e qytetërimi. Por, brezi i tyre mbeti i lidhur pazgjidhshmërisht me ëndrrën e kthyer në ankth, me ribashkimin e trojeve, që i ngjante gjithnjë e më tepër një vegimi që largohej, sepse miopia e politikës së madhe e kishte mbushur Evropën me probleme të tilla.

Për një tekë të çuditshme të historisë, ajo ëndërr do të gjente follenë e saj të sendërtimit në një gjendje jo të zakonshme, në një

kontinent që jetonte tragjedinë më të madhe të gjithë historisë së tij, në Luftën e Dytë Botërore. Ajo ditë prilli e vitit 1941, kur u vendos nga Qeveria italiane që trevat shqipfolëse, deri atëherë pjesë e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slovene, të pushtuara nga trupat aleate të Rajhut të tretë, do t’i bashkangjiteshin Perandorisë fashiste të Romës, në kuadrin e shtetit shqiptar të bashkuar me këtë të fundit, qe sendërtimi i ëndrrës tridhjetëvjeçare, edhe se në një kontekst tepër të diskutueshëm.

Mustafa Kruja, atëherë kryetar i Komisionit të Përshpagimeve shqiptare, e quajti “ditën më të bukur të jetës së tij”. Ajo ditë nuk ishte e tillë vetëm për të, ishte edhe për shumë atdhetarë të tjerë e për qindra mijëra qytetarë të Shqipërisë e viseve të saj të bashkuara me të, kryesisht për ata të Kosovës. Sa ishte e lumtur ajo ditë e bashkimit, po aq e hidhur e tragjike ishte periudha kur trupat komuniste jugosllave, të ndihmuara nga brigadat “çlirimtare” të komisarit Ramiz Alia e të tjerë personazheve të universit komunist shqiptar, shtypën qëndresën heroike të kosovarëve, të lënë dramatikisht vetëm në luftën për mbrojtjen e lirisë së trojeve të tyre.

Ajo dhunë, e ushtruar mbi Kosovën e lirë nga zaptuesit e vjetër me tjetër uniformë, me vjet

e kuqe të Moskës në kapelat e tyre, të cilëve i u shtuan, në shprehjen më të spikatur të tradhtisë kombëtare e të pabesisë njerëzore, repartet e ushtrisë “nacional-çlirimtare” të Enver Hoxhës, vrau barbarisht shpresën e rilindur të Kosovës, ëndrrën e saj e të pjesës më të madhe të shqiptarëve, për të jetuar të lirë e të bashkuar në trojet e tyre.

Ajo dhunë do të ngarkonte mbi ndërgjegjet e fituesve mijëra jetë djelmoshash të Kosovës kreshnike, që asgjësoheshin nga shki-jetë dhe bashkëpunëtorët e tij komunistë shqiptarë në emër të “revolucionit proletar”; qindra mijra kosovarë të përzënë nga shtëpitë e tyre, për t'u syrgjynosur në Anadoll, në zbatim të një strategjie afatgjatë të akademikëve të Beogradit për të zbrazur Kosovën shqiptare.

Ne sot e kujtojmë atë mynxyrë të historisë sonë, së pari me respektin e thellë ndaj heronjve të qendrës vetmitare të kosovarëve nacionalistë, si Ymer Berisha, Shaban Polluzha, Mehmet Gradica, Marije Shllaku, Ukë Sadiku, Hysen Tërpeza e qindra e mijëra luftëtarë të lirisë, por edhe me vlerësimin e nderimin e atyre figurave të historisë sonë që punuan me mish e me shpirt për Atdheun e bashkuar, që u përpoqën, me të gjitha mënyrat, t'i shmangnin atij gjysmë shekullit e mallkuar të shoqërisë sonë.

Një nga ato figura, me të veçantën e saj në lidhjet me Kosovën, ka qenë Mustafa Merlika-Kruja. Kjo trajtesë merr përsipër të jetë një rrëfim i çasteve kryesore të këtyre lidhjeve, së bashku me dëshmitë e shkruara që hedhin dritë mbi ato çaste. Në këtë rrëfim hasen ngjarje e personazhe që i përkasin historisë së Shqipërisë, asaj historie që ende sot vazhdon të trajtohet me subjektivitetin manikeist të shkronjësve besnikë, deri në vdekje, të tjetërsimit të saj, të përmbysjes së vlerave të vërteta e ngritjes në pedestal të nuliteteve të përvojës komuniste shqiptare. Ajo histori fillon herët, n'agim të

shekullit, më 1902, kur djaloshi nga Kruja, mbasi kishte mbaruar mejtepin e Mulla Hysenit në qytetin e lindjes, shkoi në Janinë për të vazhduar shkollën e mesme, duke u regjistruar në gjimnazin turk të atij qyteti. Aty krijohet lidhja e parë me një mësues nga Gjilani i Kosovës.

“Nga të gjithë eprorët e gjymnazit të Janinës, shkollë e konvikt, dy fytyra mbaj mënd të kohës s'eme qi s'dijshin me qeshun kurrë faqe nxânsash: ajo e Saib Efendiut, një tyrk prej Anadollit, hoxhë me çallëm i mësues mjaft mirë në Shkollët Normale t'Epër e mjaft i squet; dhe ajo e Qamil Efendiut, shqiptar nga Gjilani qi mâ vonë, shumë mâ vonë, atje kah vjeti 1923 me gjasë, pat ardhun në Shqipni e marrë pjesë veprimtare në jetën politike të Vëndit me titull, emën e mbiemën qi kanë njohun të gjithë intelektualët shqiptarë të kohës së tij: Prof. Qamil Bala”.

Njohja u kthye shpejt në respekt të ndërsjellët e në miqësi, që nuk mbeti në caqet e thjeshta të dashamirësisë mes mësuesit e nxënësit. Nxënësi recitonte para mësuesit “Istorinë e Skënderbeut” të Naimit dhe mësuesi e furnizonte nxënësin me kryevepra të letërsisë rinore në gjuhën frënge. Mësuesi nga Gjilani la një mbresë të thellë tek Mustafai dhe është nga të parët që fuqizoi dashurinë për kombin në zemrën e djaloshit, duke ndikuar edhe në formimin e karakterit të tij me parimet e besës e të besnikërisë.

“Po të na hetojnë halldupët sharrojmë. Po un nuk shtij këtu veçse shqiptarë e shqiptare të mirë. Na nuk mund t'i biem mohit gjakut t'onë, Kombit t'onë, Shqipnis s'onë. Por duhet t'u ruhemi fort halldupve e Shqiptarve të këqij se na marrin mbë qafë”.

Profesori u mundua të ndikonte edhe në t'ardhmen e nxënësit të tij, duke e drejtuar në vazhdimin e studimeve në inxhinieri, bazuar mbi aftësinë e spikatur të djaloshit në matematikë, lënda që i mësonte atij. Mustafai i ri u

detyrua ta ndryshojë mendimin e tij e të profesorit dhe, me këmbënguljen e Esat Pashë Toptanit, të hyjë në konkursin për Mylkije. Sa herë në jetën e tij ka qortuar veten për atë zgjedhje, mbasi politika e vuri para provash të vështira për atë dhe familjen.

Mustafai fitoi konkursin e hyri në Mylkije, shkolla e lartë e Perandorisë Otomane, për të formuar kuadrot e saj. Aty, me prirjet e tij kundër absolutistëve, u shqua në demonstratat e studentëve kundër regjimit të turqve të rinj, që zhgënjyen pritjet e kombësive të tjera, në veçanti të shqiptarëve. Filloi të shkruajë në gazetatat e Stambollit e ky kompleks veprimtarie çoi në përjashtimin e tij nga universiteti për motive politike. Sa po bëhej gati për t'u nisur në drejtim të SHBA-ës i u komunikua rikthimi në shkollë, si pasojë e ndërhyrjes së deputetëve shqiptarë në organet e arsimit.

Ndërmjet tyre ishin dhe deputetët kosovarë Hasan Prishtina e Nexhip Draga. Do të takohet me këto dy personalitete të shquara të jetës politike kosovare e shqiptare në korrikun e vitit 1912 kur, në cilësinë e sekretarit organizativ të kryengritjes shqiptare për Veriun dhe Shqipërinë e Mesme, së bashku me Markagjonin, Abdi Toptanin e të tjerë, shkuan në Shkup, për të biseduar mbi vazhdimin e kryengritjes, mbi programin dhe perspektivat e saj. Siç del edhe nga kjo pjesë, e marrë nga letra që i drejton Atë Paulin Margjokajt më 18 maj 1958, Mustafai debatoi mjaft me miqtë kosovarë mbi përfundimin e bisedimeve me Ibrahim Pashën dhe shpërndarjen e kryengritësve.

“Kosovarët kanë h më në Shkup pa pushkë, tue pasë lajmuem qeverija se ishte gati me ramë në kuvënd me kryengritësit. Edhe na lajmohemi me pezulluëm çdo veprim me armë e me dërguem në Shkup përfaqësuesit t'anë. Muerëm atë rrugë të gjatë mbë kual: Marka Gjonit (i ati i Kapidan Gjonit), Abdi Toptani e un, natyrisht të shoqnuem edhe prej

ndonji tjetri, por na të tre, demek, ishim krenët. Kur mbërrimë na në Shkup, gjithça kishte qënë kryem! Kosovarët ishin marrë veshit me Marshal Ibrahim Pashën me ato kushte qi janë njohun si 14 pikat: mbrënda katër vilajeteve qi na i kemi pasë quejtun Shqipni, kudo qi shumica e popullit flite shqip, nëpunsit do të dijshin shqip e shkollat do të mësojshin shqip; shqiptari do t'i shërbente mbretit në kohë paqe vetëm në Rumeli (në Tyrqinë e Evropës).

Këto tri pika kishin mâ tepër rëndësi e tjerat s'i mbaj mënd. Ndër krenët e Kosovës mbret-nonte khaosi, kishte ndër ta nacionalista, si Hasan Prishtinë e Bajram Curr, qi do t'a kishin rrezikuem edhe jetën e tyne për t'i siguruem Shqipnisë një autonomi të plotë; kishte koka, si Riza beg Kryeziu i Gjakovës e Isë Boletini, në polin e kundërt, qi do të kishin bâmë gjithashtu për me shliuëm Abdyl-Hamidin e me e hypun përsi në thront, me qënë Kosova e falun prej shërbimit ushtarak e taksash; kishte gjind t'urtë e të stërvitun si Nexhib Draga, qi spjegojshin se me koka t'atilla, siç ishte krejt popull' i Kosovës, fitim' i atyne 14 pikave duhej konsideruëm një mrekullë për atëherë; kishte edhe asish, ndër të parë të vëndit, qi kishin qënë gati me kthye e shkuem në shtëpi me njerëzit e tyne, porsa t'ishte marrë lajmi qi u ndërrue kabineti në Stamboll, ai i Tyrqje të Rij me një 'ancien régime”.

Të njëjtin argument e gjejmë të trajtuar edhe në një letër të gjatë që ai i shkruan profesori Stavro Skendit, më 2 nëntor 1953, me kërkesën e këtij të fundit mbi një opinion rreth “Sistemit të partive në Shqipëri”.

“Në një pjekje private që pata pasur me të ndjyerin Nexhib Draga në shtëpi të Rexhep Mitrovicës, ai më tfilloi se sikur të kishin pritur më shumë, që t'arrijshim edhe na në Shkup, kryengritja do të kishte falimentuar për faqe të zezë t'onën;

sepse dhelpira e Stambollit kishte futur agentat e saj në turnën e kryengritësve kosovarë me premtime që qeverija do t'i linte shqiptarët të mbanin armë lirisht kudo që t'ishin dhe do t'i shkarkonte kosovarët nga çdo farë pagesash të gjeratëherëshme. E në këto dy koncesjone e te mbret'i Stambollit, më thotë Draga, përmbli dhe i tërë ideal'i kosovarët. Un po shtoj se, besa, jo vetëm i kosovarët, po edhe i shumë krahinave tjera të Shqipërisë s'asaj kohe”!

Nga këto biseda me atdhetarë të provuar, ku bëhej fjalë për një çast tepër të rëndësishëm të fatëve të kombit, siç ishte kërkesa për shpëputje nga Turqia, Mustafai i ri e kuptoi se sa e vështirë ishte të thyeshin tabutë e një mendësie të ngulitur thellë në mendjet e shumë shqiptarëve që nuk mund ta konceptonin jetën e tyre pa lidhjet me Stambollin. Ishte një nga zhgënjimet e para nga jeta politike, një zhgënjim që nuk ngurron ta shpreh hapur, në formë qortimi, edhe mbas tridhjetë vitësh kur si kryeministër i Shqipërisë etnike, në fjalimin e fundit të vizitës së tij në Kosovë më 2 korrik 1942, në qytetin e Prizrenit, pohon:

“Por duhet t'a pohojmë burrnisht or vllazën, e t'a kemi si mësim para sysh se gjaku ynë i derdhun në 1912, u vjefti, jo në për lirinë qi kërkoshim, por anmiqvet t'anë, për një robni të këtyne viseve mâ të zezë se ajo e para...”!

Është një frazë që ve në dyshim një nga çastet e rëndësishme të historisë sonë bashkëkohore: dobinë e kryengritjeve shqiptare të viteve 1911-1912. A qenë në favor të çështjes shqiptare? Dobësimi i pozitave të Turqisë në Ballkan qe më i dobishëm për Shqipërinë, apo për shtetet fqinjë të saj që ishin të pavarura? Është një pyetje që dëshmon relativitetin e vendimeve historike që, me kalimin e kohës, pësojnë vlerësime të ndryshme, herë-herë edhe të kundërta. Revolucionari atdhetar Kruja, më 1912, hartonte të gjitha shpalljet, përkujtesat e dokumentet e kryengritjes, duke kërkuar autonominë e shkallës më të lartë.

Luftërat ballkanike dhe gjymtimi i trevave shqiptare ishin pasojë edhe e dobësimit të pozitave të Perandorisë në Ballkan, dobësim që, së fundi, doli i dëmshëm për Shqipërinë, mbasi zëvendësoi sundimin turk me atë të serbëve, malazezëve e grekëve mbi krahinat shqiptare, duke dëmtuar rëndë integritetin tokësor të Shqipërisë s'ardhme. Kryeministri Kruja, më 1942, e ka përvehtësuar mësimin e 1912-ës dhe u a kujton bashkatdhetarëve, për të mos rënë më në gabime t'atij lloji. Fatkeqësisht ky mësim nuk u muar për bazë dhe nuk u zbatua nga drejtuesit komunistë shqiptarë që flijuan trevat shqiptare, duke u a dorëzuar jugosllavëve, për të ruajtur pushtetin e tyre, të siguruar nga Titoja dhe Stalini.



E rrallë

Peshkaqeni 'engjëll'?



Organizata mjedisore "iSea", e cila zbaton programin për ta mbështetur mbrojtjen e peshkaqenëve "engjëj" në Egjeun Jugor, ka zhvilluar një plan masash për ta mbrojtur specien e një

peshkaqeni që i përket një prej grupeve më të rrezikuar të peshkaqenëve në botë, me mbështetjen e Fondit për Ruajtjen e Peshkaqenëve. Sipas njoftimit të organizatës, "tre specie peshkaqenësh

gjenden në Mesdhe dhe popullatat e tyre janë përshkruar si të rrezikuara në mënyrë kritike nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës për shkak të rënies së shpejtë të popullsisë së tyre".

BARSOLETA E DITËS



Veterineri: Gruaja juaj është këtu me macen dhe kërkon t'i bëjë eutanzion (shkaktim i vdekjes në mënyrë mjekësore). Pajtoheni ju me këtë?

Burri: Po, patjetër. Kurse macen lëshojeni se di të shkojë vetë në shtëpi.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Panorama mahnitëse që na ofron Radhima



E jashtëzakonshme

Japonia kalon për herë të parë numrin 80 000 me të moshuar 100-vjeçar

Numri i personave të moshës mbi 100-vjeçare në Japoni për herë të parë ka shkuar në mbi 80 000. Ministria e Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies e Japonisë ka përditësuar të dhënat e personave mbi moshën 100 vjeç, bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë. Të dhënat tashmë prej 50 vjetësh kanë shënuar një rritje të vazhdueshme, ndërsa gratë, me 88 për qind, përbëjnë pjesën më të madhe.



DASHI

Në punë gjithçka do të shkojë

ashtu si ju e prisni. Marrëdhëniet shoqërore do të rriten, shtrëngojni duart me njerëzit që kanë rëndësi për ju.



DEMI

Do të përballeni me optimizëm,

vetëvlerësim dhe do të merrni shumë komplimente nga të tjerët.



BINJAKËT

Mos u bëni përshtypje, nëse shfaqet

lodhja dhe forma fizike është nën nivelet e zakonshme: Hëna në të dymbëdhjetën do t'ju ndihmojë të kaloni këtë gjendje.



GAFORRJA

Ju do të jeni në gjendje ta çlironi

mendjen tuaj, duke e çliruar atë nga zinxhirët e gjykimeve dhe mendimeve të zakonshme të pandryshueshme.



LUANI

Qëndrimi në pozicione të caktuara nuk do t'ju

ndihmojë të arrini një marrëveshje. Sa i përket partnerit ora juaj ka ndaluar te një dashuri e vjetër me të cilën është e pamundur të jeni bashkë.



VIRGJËRËSHA

Është koha të nxitoni për të arritur një

çast të rëndësishëm. Nuk do t'ju mungojnë idetë dhe mundësitë për ta përmirësuar aktivitetin tuaj profesional.



PESHORJA

Emocionet e fuqishme kërkojnë të përjetohen.

Ju do t'i kapërceni të gjitha vështirësitë, nëse mund t'i menaxhoni me shkathësi edhe ato të papriturat.



AKREPI

Do të jeni në gjendje të mbani larg ata që

ju ofrojnë një rrugë të shkurtër për të arritur në destinacionin tuaj.



SHIGJETARI

Yjet ju ftojnë të kujdeseni për

shëndetin tuaj, duke filluar me të ushqyerit. Duhet t'u thoni jo ushqimeve pikante, të përpunuara, të skuqura.



BRICJAPI

Ajo do t'ju ndihmojë të ndiheni

më të lehtë dhe më të përgatitur për t'i përballuar angazhimet dhe vështirësitë e momentit.



UJORI

Emocionet dhe ndjenjat nuk janë

në gjendje të përqendrohen në konkretësinë e gjërave, më mirë të presim me kujdes disa ditë.



PESHQIT

Gjatë gjithë kësaj dite do të jeni e

karakterizuar nga ritme shumë të gjalla. Në punën tuaj, përdorni mirë simpatinë, veçanërisht nëse punoni në kontakt me publikun.

Princi Harry feston 36-vjetorin, “Royal family” përjashton Meghan nga postimet e urimeve



Ditëlindja e parë larg familjes “royal” për Princin Harry, që duke nisur nga ky vit do të festojë thjesht si një kalifornian dhe jo si një anglez fisnik. Për 36-vjetorin e tij asnjë pritje me Mbretëreshën Elisabetta, me të cilën i ndan një oqean. Por babai, gjyshja dhe vëllai nuk kanë harruar dhe në rrjetet sociale kanë ndarë një postim dhe një urim. Postimi i bërë nga Kate Middleton dhe William është në mënyrë të veçantë më sinjifikativ. Një foto e vjetër në të cilën të tre shfaqen shumë të gëzuar.

Miley Cyrus dhe Dua Lipa kanë gati bashkëpunimin e parë



Dua Lipa dhe Miley Cyrus janë dy këngëtare të suksesshme të cilat kanë edhe një miqësi shumë të mirë. Së fundmi këngëtarja me origjinë shqiptare ka pohuar se do të jetë pjesë e albumit më të ri të Miley Cyrus të titulluar “She is Miley Cyrus”. Këtë lajm e ka konfirmuar

vetë këngëtarja për “The Edge”. Dy vajzat kanë bashkuar forcat për një projekt muzikor që Miley mesa duket e ka shumë për zemër. Pjesë e këtij albumi gjithashtu do të jetë edhe Billy Idol, por këngëtarja ka vendosur të mos ndajë shumë detaje rreth këtyre prurjeve, madje as për albumin e ri.



Cardi B firmos dokumentet e divorcit nga Offset

Reperja e njohur Cardi B ka vendosur të ndahet nga bashkëshorti i saj Offset, pas tri vjetësh së bashku. Cardi ka firmosur dokumentet e divorcit dhe ka kërkuar kujdestarinë e vajzës. Cardi u martua me reperin në një ceremoni sekrete në vitin 2017 dhe ata kanë një vajzë dyvjeçare që quhet Kulture, megjithatë romanca e tyre mori

fund pasi u raportua se Offset e kishte tradhtuar reperen më shumë se një herë. Dokumentet e gjykatës deklarojnë se nuk ka perspektivë për një pajtim mes çiftit dhe se marrëdhënia është prishur në mënyrë të pakthyeshme. Sidoqoftë, dokumentet shtojnë se Cardi shpreson që divorci të zgjidhet me marrëveshje mes palëve.

Ronaldo relaksohet me pizhame, por Georgina me bikini i çmend të gjithë



Pa asnjë të metë, Georgina Rodriguez është e mrekullueshme me bikini. Nëse Cristiano Ronaldo ka nisur impenjimet me skuadrën e tij, modeluesja nuk ka mbetur prapa, duke ndarë fotografi me pizhame nga jahti, ajo përgjigjet me fotografi shumë erotike,

ku gjysmë e zhveshur tregon format e saj marramendëse që çmendin fansat e saj. Lady Ronaldo merr vëmendjen e të gjithëve me fizikun e saj. Pas shfaqjes së mrekullueshme në Venecia ku i ka magjepsur të gjithë, modeluesja kthehet në impenjimet e saj profesionale, teksa realizon një set të ri fotografik.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina konfirmon largimin e Dallkut dhe ardhjen e Ramadanit

FC Prishtina të mërkurën ka qenë skuadër mjaft aktive, pasi ka konfirmuar ndryshimet në shtabin teknik. Në vend të Armend Dallkut është emëruar Zekirija Ramadan. Gjithashtu, të mërkurën katër futbollistët: Lorik Boshnjaku, Endrit Krasniqi, Eglant Haxho dhe Alban Muçiqi kanë rinovuar kontratat me klubin më të madh në vend



për mua ta udhëheq Prishtinën. Patjetër që do të jetë përgjegjësi, sepse Prishtina është klubi ndër më të mëdhenjtë në rajon. Normalisht se duhet punuar shumë që të arrihet objektivi. Ishin të qartë edhe drejtuesit të cilët i falënderoj për besimin që më kanë dhënë për ta drejtuar ekipin e Prishtinës. Shpresoj dhe besoj që deri në fund t'i arrijmë objektivat duke besuar në kolektiv, në stafin teknik dhe në drejtuesit e klubit", ka thënë Ramadan.

"Epoka e re"

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Skuadra e Prishtinës të mërkurën ka konfirmuar se ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Armend Dallku. Në fakt, ky bashkëpunim është ndërprerë para dhjetë ditësh, por klubi kryeqytetas vendosi të mos e bëjë publik deri tash. "Prishtina ka

shkëputur bashkëpunimin me marrëveshje reciproke me kryetrajnerin Armend Dallku. Dallku do të mbetet ndër trajnerët më me autoritet i skuadrës. FC Prishtina i uron sukses në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Dallku e ka udhëhequr klubin e Prishtinës në 35 ndeshje zyrtare dhe ka regjistruar 23 fitore, 7 barazime dhe 5 humbje me

goldallim 73:25, kurse është trajneri më i ri i klubit me trofeun e fituar të Kupës së Kosovës. Skuadra "bardhekalte" të mërkurën e konfirmoi edhe pasardhësin e Dallkut, Zekirija Ramadan. Ky i fundit ishte shpallur kampion i Kosovës me

Trepçën '89 dhe Feronikelin. Ndërsa ka udhëhequr edhe Shkupin dhe Flamurtarin e Vlorës. Trajneri i ri i Prishtinës, Zekirija Ramadan, ka thënë për faqen zyrtare të këtij klubi se është një privilegj i madh për ta udhëhequr Prishtinën. "Është privilegj i madh

FC Prishtina ka rinovuar edhe kontratat me katër futbollistët. Mesfushorët Lorik Boshnjaku dhe Endrit Krasniqi do të jenë pjesë e kryeqytetasve edhe për disa vite, kurse portierët Eglant Haxho e Alban Muçiqi kanë nënshkruar kontrata të reja njëvjeçare.

Karriera e bujshme e Maxhunit, nga hapat e parë në basketboll e deri tek trofetë

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Një nga personat që ka dhënë kontribut të madh në basketbollin e Kosovës është Bekim Maxhuni. Ish-lojtari i shumë skuadrave në Kosovë, por edhe më gjerë, në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së ka treguar si filloi me basketboll, trofetë më të veçantë, ndeshjet e paharrueshme, kundërshtarin më të vështirë dhe mesazhi për lojtarët e rinj. Maxhuni ka fituar trofe me Trepçën, Prishtinën e Dritën, kurse ka luajtur edhe me Alba Berlinin në Gjermani, derisa me sukses zhvilloi karrierën në Maqedoni për Shkëndijën e Tetovës dhe Gostivarin. Ai ka luajtur për Besianën, Yllin, Exklusivin dhe Kastriotin, si dhe ishte trajner për grupmosha të reja, kurse tani është përzgjedhës i Kosovës U20 (M). Bekim Maxhuni gjithashtu për shumë vite ishte shënuesi më i mirë në ligë për skuadrat ku ka luajtur, si te Shkëndija, Drita, Ylli, Exklusivin.



Si vendose të luaje basketboll?
Babai im ka qenë shtytës për mua të luaj basketboll edhe pse është trajner i mirënjohur i futbollit kosovar. Ai më sugjeroi të merrem me basketboll qysh në moshën 9-vjeçare.

Cili ka qenë idhulli yt në fëmijëri?
Në atë kohë idhulli im prej lojtarëve vendorë ka qenë Vllaznim Perani, kurse jashtë vendit mund të cekim Drazhen Petroviq, Toni Kukoc etj.

Cili ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?
Kam fituar tre tituj në kampionatin e Kosovës. Me Trepçën, Prishtinën dhe me Dritën e Gjilanit. Nuk është e lehtë të fitosh tre tituj me skuadra të ndryshme dhe trofetë kanë qenë të veçantë.

Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?
Ka shumë ndeshje, të cilat kanë pasur rëndësi të veçantë për mua. Por, e veçoj në Maqedoni, ku kam luajtur për Gostivarin në Superligën e Maqedonisë kundër MZT Skopje, ku shënova 28 pikë, kurse në Kosovë me Exklusivin ndaj Pejës e Prishtinës, por vlen të përmendet edhe lojën sa isha në Berlin te Alba Berlin ndaj Përfaqësueses së Bosnjës.

Cili ka qenë kundërshtari më i vështirë që je ballafaquar?
Ka pasur jashtëzakonisht kundërshtarë të fortë, secili prej

tyre ka pasur diçka të veçantë. Lojtarët cilësorë jashtë vendit kanë qenë më të vështirë, kurse në Kosovë, me lojtarin Hashim Simmons, i cili ka luajtur për Trepçën. Një basketbollist i jashtëzakonshëm me performanca të një lojtari të Euroligës.

Sa të mungon basketbolli dhe atmosfera nga koha kur ke luajtur?
Basketbolli më mungon shumë, posaçërisht në mënyrën profesionale se, këtu ende nuk kemi mbërritur atë nivel të profesionalizmit. Këtu ka vetëm improvizim. Kurse atmosfera është ajo që e ka mbajtur basketbollin e Kosovës.

Cili është mesazhi për lojtarët e rinj që duan të merren me basketboll?
Punë, punë, vetëm punë, nëse dëshironi me arrit diçka në basketboll dhe jashtë tij.

Liria i shkruan Lazios, kërkon kompensimin për transferimin e Muriqit

PRIZREN, 16 SHTATOR - Skuadra e Lirisë së Prizrenit i ka shkruar letër zyrtare skuadrës së Lazios për rastin e transferimit të sulmuesit Vedat Muriqit nga Fenerbahçe te Lazio. "Gjatë procedurave të transferimit për lojtarin midis SS Lazio dhe Fenerbahçe SK duhet t'i merrni parasysh kompensimet

për klubin tonë gjithmonë sipas rregullave të parashikuara nga FIFA", thuhet në letrën e KF Liria. "Ne dëshirojmë t'ju informojmë paraprakisht se futbollisti Vedat Muriqi është një lojtar që është rritur dhe zhvilluar si futbollist nga akademia e shkollës sonë të futbollit. Vedati Muriqi ka luajtur në

klubin tonë për herë të parë si një futbollist profesional (bashkangjitur ju keni kontratën e tij me klubin tonë të verifikuar nga Federata e Futbollit të Kosovës) për ta vazhduar karrierën e tij të bujshme në Shqipëri dhe më pas në Turqi. Pas konsultimeve me Federatën tonë të Futbollit dhe njohës të mirë të

rregullave të FIFA-s po ju shkruajmë zyrtarisht, që gjatë procedurave të transferimit për lojtarin midis SS Lazio dhe Fenerbahçe SK, duhet t'i merrni parasysh kompensimet për klubin tonë gjithmonë sipas rregullave të parashikuara nga FIFA", thuhet në letrën e skuadrës së Lirisë.



Sonte zhvillohet ndeshja Sileks - Drita

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, sonte (e enjte) do të përballlet me skuadrën e Sileksit, në ndeshjen e raundit të dytë eliminator në Ligën e Evropës. Lidhur me këtë ndeshje ka folur sul-

muesi i Dritës, Kastriot Rexha, i cili është optimist se gjilanasit mund ta sigurojnë kualifikimin më tutje. "Jemi duke u përgatitur mirë për këtë ndeshje mjaft të rëndësishme për me. Po ashtu, kemi mbajtur në Shqipëri

karantinë dhe kemi bërë përgatitje speciale për këtë ndeshje. Kemi parë edhe disa ndeshje të cilat ata kanë zhvilluar dhe mendoj se është e mundur ta kalojmë Sileksin. Skuadra ka treguar performanca të mira dhe do të

shkojmë me besim për kualifikim më tutje", ka thënë Rexha. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 20:00 në stadiumin "Todor Proeski" në Shkup me dyer të mbyllura, pa praninë e publikut, për shkak të pandemisë Covid-19.



Ademi merr pjesë në takimin online me presidentët e 55 federatave anëtare të UEFA-s

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Të martën është mbajtur takimi online i presidentit të UEFA-s, Aleksander Čeferin, me 55 presidentët e federatave anëtare. Në këtë takim dyorësh, në të cilin mori pjesë kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, u bisedua për situatën aktuale në secilën federatë, për gjendjen e pandemisë, ndeshjet e ekipeve kombëtare të meshkujve dhe të femrave, të klubeve, të futbollit si dhe rrjedhën e fillimit të kampionateve, rikthimin e tifozëve në stadione dhe për reziqet financiare si pasojë e pandemisë. Gjatë këtij takimi u dakordua që federatat të jenë në kontakt të vazhdueshëm me UEFA-n dhe për çdo ndryshim eventuale të situatës së pandemisë apo situatave të tjera të lajmërohen organet e UEFA-s. Presidenti Čeferin ka thënë se UEFA e kupton vështirësinë e federatave për zhvillimin e kampionateve nacionale ngaqë varet nga autoritetet e secilit shtet, të cilat herë janë në listën e kuqe e herë në listën e gjelbër të situatës së pandemisë, por se futboli duhet të vazhdojë normalisht nën respektimin e protokollit shëndetësor sepse, siç ka thënë Čeferin, vetëm me sport mund ta



ndryshojmë ndjenjën dhe ta llogojmë frikën e njerëzve nga Covid-19. Më tutje, presidenti i UEFA-s ka shprehur besimin e tij se shumë shpejt do ta kthejnë një numër të tifozëve në stadione dhe për këtë qëllim janë duke zhvilluar bisedime me autoritetet e secilit shtet. Ai bëri me dije se një vendim për këtë çështje do të merret shumë shpejt teksa u shpreh i lumtur që ka filluar edicioni i ri. Njëherësh Čeferin kërkoi që në të gjitha federatat aktorët e ndeshjeve dhe anëtarët e federatave të jenë mirëkuptues dhe mos të bëhen pengesë e zhvillimit

të futbollit. Po ashtu, ai ftoj të gjithë që t'i dëgjojnë këshillat e presidentëve dhe Komiteteteve Ekzekutive të federatave sepse ata janë më të informuarit dhe i dinë më së miri edhe vështirësitë financiare. Në fund, Čeferin shprehu shpresën se edhe autoritetet e secilit shtet do të ndihmojnë në lejimin e zhvillimit të futbollit dhe në investim në këtë periudhë të vështirë. Në fund të takimit të 55 presidentët e federatave anëtare i përkrahën vendimet e presidentit Čeferin dhe të UEFA-s për zhvillimin e futbollit dhe të ndeshjeve.

Miami fitoi finalen e parë ndaj Bostonit, Denveri kualifikohet në finalen e Perëndimit

ORLANDO, 16 SHTATOR - Pasi eliminoi Milwaukee në gjysmëfinale ekipi i Miamit e nisi mbarë edhe finalen e "play-off"-it në Konferencën e Lindjes. Skuadra nga Florida fitoi 117-114 ndaj Bostonit në finalen e parë pas kohës shtesë, në një ndeshje me shumë emocione e rivalitet. Bostoni e udhëhoqi ndeshjen shumicën e kohës,



madje u shkoput deri në 14 pikë, por pa mundur të fitojë. Tatum realizoi 30 pikë e 14 rebounde, por që s'mjaftuan për Celticsin, ndërsa për Miamin u dallua Dragiq me 29 pikë, mbështetur nga Crwoder me 22 pikë e Butleri me 20 pikë, raporton "Telesport". Në Perëndim, skuadra e Denverit është finalistja e dytë e "play-off"-it, pas fitores 104-89 ndaj Clippersve, në gjysmëfinalen e shtatë. Nuggets fitoi 4-3 serinë e ndeshjeve, duke arritur një rezultat surprizë. Në këtë ndeshje skuadra e Clippersit zhgënjeu me liderët e saj (Harrell shënuesi më i mirë me 20 pikë), ndërsa për Denverin u dallua Murray me 40 pikë. Denveri do të luajë në finalen e Perëndimit ndaj Lakersave.

KONFERENCA E LINDJES - FINALE "PLAY-OFF"

Miami - Boston 117-114 (1-0)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Clippers - Denver 89-104 (3-4)
Lakers - Houston (4-1)

SHKURT

Muriqi te Lazio, Teuta dhe Besa mbushin 'arkat'

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, është transferuar te Lazio në Serinë A për shifrën 18 milionë euro. 26-vjeçari ka firmosur një kontratë pesëvjeçare me klubin italian, teksa pritet të përfitojë rreth 2 milionë euro në sezon. Nga ky transferim i bujshëm përfitojnë edhe dy klubet shqiptare, Teuta dhe Besa e Kavajës, për të drejtën e formimit të lojtarit deri në moshën 23-vjeçare. Kujtojmë që Muriqi është aktivizuar me dy klubet shqiptare në sezonin 2013-2014. "Panorama Sport" mëson se Teuta përfiton plot 270 mijë euro nga shitja e Muriqit, ndërkohë që 90 mijë euro do të përfitojë Besa e Kavajës.

Leci ka këputur ligamentet

Skuadra e Llapit ka pësuar një goditje të rëndë, pasi transferimi Liridon Leci ka pësuar lëndim të rëndë para fillimit të kampionatit. "Olle" raporton se Leci ka këputur ligamentet e këmbës së djathtë. Leci u dëmtua në miqësoren e Llapit me Skënderbeun në Shqipëri. Lojtari ka bërë rezonancën, ku u kuptua që ka këputur ligamentet e këmbës së djathtë. Ai ka filluar menjëherë fazën rehabilituese.

Bundesliga me tifozë

Futboli gjerman ka vendosur të hapë dyert për tifozët, por fillimisht vetëm për gjashtë javët e para. Bundesliga do të luhet me tifozë dhe ky është një lajm i mirë për futbollin që, pas Francës, lejojnë një numër të konsideruar tifozësh në stadione. Këshilli Shtetëror i Rajoneve të Gjermanisë miratoi propozimin për të lejuar në gjashtë javët e para të kampionatit që tifozët të futen në stadione. Sipas këtij udhëzimi, klubet kanë të drejtë t'i mbushin stadiumet e tyre deri në 20 për qind të kapacitetit. Nëse nuk do të ketë shtim të personave të infektuar me koronavirus, atëherë autoritetet gjermane do ta lejojnë ndjekjen e ndeshjeve me një kuotë të tifozëve në stadione deri në fund të sezonit.

Liverpooli, ofertë të re për Thiago

Kampioni i Anglisë, Liverpooli, ende nuk ka hequr dorë nga transferimi i Thiago Alcantaras. Mesfushori spanjoll nuk e ka përjashtuar mundësinë e qëndrimit në Bayern Munchen, por klubi gjerman është i vendosur se nëse nuk rinovohet kontrata, ta shesë për shkak se verën e ardhshme Thiago do ta largohet me parametrat zero. Liverpooli e ka gati ofertën që është rreth 50 milionë euro, derisa interesim për Thaignon ka shfaqur edhe Manchester United.

'Spurs' ofron Dele Alin per Balen

Tottenhami është shumë afër që ta rikthejë Gareth Bale në Londër. Mediat britanike raportojnë se Real Madridi do të pranojë të paguajë mbi 50 për qind të pagës faraonike (500 000 stërlina në javë) të Bale, në mënyrë që të arrihet marrëveshja. Menaxheri i 31-vjeçarit, Jonathan Barnett, pranoi se klienti i tij është në bisedime të avancuara me Tottenhamin, pasi është klubi ku dëshiron të luajë në Premierligë "Spurs"-at janë gati që në marrëveshje ta përfshijnë mesfushorin Dele Alli.

Komuna e Leposaviqit
Numer:259
Data:17.09.2020.
Leposaviq

Ne baze te nenit 8. paragrafi 1. Te Ligjit te punes Nr. 03/L-212, nenit 4. paragrafi Te Udhezimit Administrativ dhe rregullimin e procedures ne mardhenje pune ne sektorin publik nr. 07/2017, Komuna e Leposaviqit daten 17.09.2020. shpall:

KONKURS

Per vendet e punes ne vijim

DEPARTAMENTI SHENDETËSISË

1. Emrimi ne vendin e punes: Staf i mbështetje
 Kushtet: Shkolla e mesme e mbarimit
 Radno vreme: 40 ore ne jave
 Broj izvrshilaca: 2

2. Titulli i verndit te punes: Zyrar Administrativ
 Kushtet: Kryer edukukimin e Lartë shkollor
 Orari i punes: 40 ore ne jave
 Numer kryes detyre: 1

Periudha e perfundimit te kontrates: puna provuese ne afat deri ne 6 (gjasht) muaj, me mundesi vazhdimi i kontrates.

Kandidati duhet te jete: moshes madhore, I aft per punedhe te mos eshte i denuar per ndonje veper penale qe e ben qe e bent e papershtatshem per kryerjen e e detyres qe perfshihet denimi me burgim nga 6(gjasht) muaj e me shume.

Dokumentet e nevojshme: kopja e leternjoftimit, kopja e diplomes valide (nga shkolla e lart dhe fakulteti vertetuar nga noteri), vertetimi nga Gjygyji qe nuk eshte nen hetime, Qertifikatat

Aplikacionet mund te meren dhe dorezohen qdo dit pune ne zyren nr.10 Komuna e Leposaviqit – Rruga Vojske Jugoslavije 33, ne periudhen kohore nga ora 8:00 deri 14:00

Vetem kandidatet nga nje liste e ngusht do te zgjedhen, dhe do te kontaktohen me (e-mail) ose ne munges vertetimit me e-mail nga ana e kandidatit, do te jene te njoftuar permes telefonit. Kandidatet jane te detyruar te sjellin me vete dokumentacionin original, ne rast se nuk i sjellin dokumentet original, kandidatet do te perjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi do te qendroj i hapur 15 dite kalendarike nga data e shpalljes.

Verejtje: Dokumentacioni jo me kohe ose i pakompletuar nuk do te merret parasysh.

Lumë's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Opština Leposavić
Broj:259
Datum:17.09.2020.god.
Leposavić

Na osnovu člana 8. stav 1. Zakona o radu Br. 03/L-212, člana 4. stav 1. Administrativnog uputstva za regulisanje procedura radnog odnosa u javnom sektoru br. 07/2017, opština Leposavić dana 17.09.2020. godine, objavljuje:

KONKURS

za sledeća radna mesta

ODELJENJE ZA ZDRAVSTVO

1.Naziv radnog mesta: Pomoćno Osoblje
 Uslovi: Završena srednja škola
 Radno vreme: 40 sati nedeljno
 Broj izvršilaca: 2

2.Naziv radnog mesta: Administrativni službenik
 Uslovi: Završena VŠS (Viša stručna sprema)
 Radno vreme: 40 sati nedeljno
 Broj izvršilaca: 1

Period zaključenja ugovora: Probni rad u trajanju od najmanje 6 (šest) meseci, uz mogućnost produženja ugovora.

Kandidat mora biti: punoletan, poslovno sposoban i da nije osuđivan za krivično delo koje ga čini nepodobnim za vršenje posla za koje se izriče kazna zatvora u trajanju od 6 (šest) i više meseci.

Potrebna dokumentacija: fotokopija lične karte, fotokopija validne diplome (za više škole i fakultete overena kod notara), potvrda iz suda da lice nije osuđivano, sertifikati.

Aplikacije se mogu preuzeti i podneti svakog radnog dana u kancelariji br.10 opštine Leposavić – ulica Vojske Jugoslavije 33, u periodu od 8:00 do 14:00 časova.

Samo izabrani kandidati sa uže liste,biće kontaktirani putem (e-maila) ili u nedostatku potvrdjivanja e-mailom od strane kandidata,biće obavesteni putem telefona. Kandidati su dužni da ponesu sa sobom originalna dokumenta,u slučaju nedostavljanja originalne dokumentacije, kandidati će biti isključeni iz regrutacione procedure.

Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih od dana objavljivanja.

Napomena: Neblagovremena i nekompletna dokumentacija neće biti razmatrana.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Andrin Kabashi shpall të pavlefshme certifikatën e shkollës së mesme "Sami Frashëri" Prishtinë.

► Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehe qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Avni Isuf Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.

► Bali Salih nga fshati Ticë shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore SHFMU "Ismet Uka" Ticë Skenderaj.

► Zyrafete Imer Dani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj klasa I-VIII.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studente ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

